



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Hartëzimi dhe vlerësimi i rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri

Raport Vlerësimi

Tiranë, 2019

Hartëzimi dhe vlerësimi

i rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Tiranë, Shqipëri 2019

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Email: partners@partnersalbania.org

Website: www.partnersalbania.org

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile

Email: info@resourcecentre.al

Website: www.resourcecentre.al

Rruga e Elbasanit, Godina Park Gate, Kati I 10-të,
Ap. 71 / 73, PO BOX 2418/1
Kodi Postar 1010, Tirana, Albania
Tel: +355 4 2254881

Ky raport është realizuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Informacioni dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. As institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, as cilindo person që vepron në emër të tyre, nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimin që mund të bëhet nga informacioni që përmban ai.

Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri falenderon të gjitha organizatat dhe rrjetet për bashkëpunimin dhe përfshirjen në realizimin e këtij studimi.

Përgatitur nga:

Autor kryesor

Ramadan Sopot

Grupi i vëzhgimit

Ramadan Sopot

Xhoana Zeqo

Shkrimi i raportit

Ramadan Sopot

Ariola Agolli

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje Ekzekutive.....	4
Hyrja	7
Pasqyrë e Shoqërisë Civile Shqiptare	8
Përcaktimi i rrjeteve dhe koalicioneve të shoqërisë civile.....	9
Hartëzimi i rrjeteve të OSHC-ve në Shqipëri – Pasaportat e rrjeteve	11
Rishikimi i literaturës	13
Gjetjet kryesore	15
Karakteristikat e Rrjeteve	15
Qëllimi i rrjetit	15
Struktura	16
Dimensionet e rëndësishme	20
Faktorët nxitës dhe drejtues të Rrjetëzimit	20
Relevanca	21
Kapacitetet	23
Anëtarësia	25
Rrjetëzimi	27
Situata e rrjeteve dhe perspektivat e ardhshme	28
Konkluzione.....	32
Referenca	34
Shtojcë 1: Pasaportat e Rrjeteve.....	35

Përmbledhje Ekzekutive

Fuqizimi i rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) është një element i rëndësishëm i zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri mbështet ndërtimin e kapaciteteve të rrjeteve dhe fuqizimin e tyre, si pjesë e objektivave të saj strategjikë për të forcuar kapacitetet e shoqërisë civile dhe për të kontribuar në krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile, demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë një panoramë të rrjeteve dhe koalicioneve të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, si dhe të vlerësojë kapacitetet e nevojat e tyre për të mbështetur më tej zhvillimin dhe punën e vazhdueshme të rrjeteve e koalicioneve në vend. Një vlerësim i tillë shërben për të informuar, ngritur pyetje dhe për të çelur një diskutim rreth rrjeteve, në kontekstin e zhvillimit.

Sot, rrjetet janë një pjesë e rëndësishme e shoqërisë dhe ekzistojnë pothuajse kudo në botë. Vlera e rrjeteve në fushën e zhvillimit është njohur e pranuar nga shumë donatorë. Ka një nevojë të madhe për të mësuar më shumë rreth rrjeteve dhe për të kuptuar kontributin që ata mund të japin.

Ekziston një shumëllojshmëri e nën-kategorive të rrjeteve, mes të cilëve mund të përmendim disa si: komunitetet e praktikës, rrjetet e njohurive, rrjetet sektoriale, rrjetet për ndryshime sociale ose advokim, ose rrjetet e ofrimit të shërbimeve, etj. Kjo shumëllojshmëri tregon për faktin se rrjetet janë krijuar për një larmi qëllimesh dhe materializohen në një sërë strukturash. Ata mund të jenë organizime si formale dhe informale e mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si në nivel lokal dhe në atë kombëtar. Ata janë më shumë sesa thjesht një qendër burimore për anëtarët e tyre - shumica e rrjeteve përfshijnë bashkëpunim të anëtarëve dhe angazhim në aktivitete të përbashkëta.

Rrjetet efektive posedojnë karakteristika të kapitalit të fortë shoqëror, udhëheqjes, qeverisjes dhe menaxhimit, mësimit së bashku dhe partneritetit me donatorë. Rrjetet efektive kanë një anëtarësi dhe strukturë të ndryshme, dinamike dhe janë të përkushtuar për përsosmëri dhe procese vendimmarrëse demokratike.

Formimi i rrjetit (forcat nxitëse dhe drejtuese)

Nuk ekziston asnjë formulë se *si* dhe *pse* zhvillohet një rrjet. Formimi i rrjetit mund të nxitet nga burime të jashtme ose të brendshme, ose për arsye praktike ose të bazuara në vlera. Rrjetet mund të formohen me një qasje nga lart-poshtë ose nga poshtë-lart. Në fakt, shpeshherë është një kombinim i të gjithë këtyre faktorëve që shërben si shtysë për formimin e rrjetit. Rrjetet evoluojnë me kalimin e kohës dhe mund të ndryshojnë ndjeshëm në nivelin e formalizimit në faza të ndryshme të cikleve të tyre të jetës. Ndërkohë që shumë rrjete gradualisht formalizohen, ky formalizim nuk është aspak i domosdoshëm për të gjithë. Struktura që një rrjet vendos të ketë,

formohet nga motivimi dhe mënyra e formimit të atij rrjeti, si dhe qëllimet për të cilat rrjeti është krijuar ose zhvilluar.

Ndërsa shumë rrjete formohen me qëllimin për të funksionuar në mënyrë të qendrueshme dhe afatgjatë, disa prej tyre formohen si përgjigje ndaj një stimuli shumë specifik dhe zgjasin për një kohë të caktuar. Për të siguruar që po përgjigjen ndaj nevojave të anëtarëve të tyre, rrjetet duhet të vlerësojnë vazhdimisht të gjithë elementet e funksionimit të tyre. Nëse një rrjet nuk plotëson më nevojat e anëtarëve të tij, pjesëmarrja do të ulet dhe rrjeti natyrisht do të pushojë së ekzistuari. Ne besojmë se marrja në konsideratë e qëndrueshmërisë së përfitimeve, siç është ndërtimi i kapitalit të fortë shoqëror, është një koncept më i dobishëm për t'u përdorur në lidhje me rrjetet sesa qëndrueshmëria e strukturës.

Përfitimet e anëtarësimit në rrjet

Përfitimet që perceptohen lidhur me të qenit anëtar në një rrjet janë të shumta. Disa nga përfitimet më të përmendura për anëtarët e rrjetit janë: impakt më i madh në advokasi, rritja e aksesit në informacion; ekspertizë dhe burime financiare; një efekt përshkallëzues, i cili rrit shtrirjen dhe ndikimin në organizatat anëtare; solidaritet dhe mbështetje; dhe rritje e vizibilitetit të çështjeve, praktikave më të mira dhe grupeve të nën-përfaqësuar. Përfitime të tjera të rëndësishme të perceptuara janë zbutja e rrezikut, ulja e izolimit dhe rritja e besueshmërisë, veçanërisht për zhvillimin e OSHC-ve. Ekzistojnë gjithashtu rreze të konsiderueshme për anëtarësinë e rrjetit, kështu që OSHC-të që planifikojnë të bëhen pjesë në një rrjet duhet të ndërmarrin një analizë kosto / përfitim për të përcaktuar nëse pjesëmarrja në rrjet do të përmbushë apo jo nevojat e tyre të veçanta.

Sfidat e punës në ekip

Të bërit bashkë e shumë palëve të interesuara me një larmi ekspertizash dhe perspektivash për të arritur qëllimet e përbashkëta është një veprim i mençur, por shpeshherë i vështirë për t'u realizuar. Edhe nëse qëllimi i rrjetit kuptohet gjerësisht kur një grup mblidhet për herë të parë, mund të jetë e vështirë të kuptohet nga ku duhet të fillojë trajtimi i çështjes në fjalë. Në momentin që fillon, rrjeti mund të përballë me sfida dhe barriera në realizimin e planit të tij strategjik. Disa nga sfidat më të përmendura janë: mungesa e gatishmërisë së anëtarëve për t'u përfshirë në aktivitetet e rrjetit, mungesa e fondeve për të mbështetur aktivitetet e rrjetit dhe dëshira për protagonizëm e disa anëtarëve, që në disa raste krijon mospërputhje me punën në ekip.

Nevojat për programin e ngritjes së kapaciteteve

Kontributi i rrjeteve të OSHC-ve në ndërtimin e kapacitetit organizativ të anëtarëve të tyre është kompleks. Në thelb, qëllimi i ngritjes së kapaciteteve organizative të OSHC-ve është të mundësojë që OSHC-të të jenë organizata që kanë besim në vete, të pavarura dhe efektive që sjellin ndryshime në jetën e njerëzve, komuniteteve dhe vendeve ku shtrijnë veprimtarinë e tyre, si dhe të japin një kontribut në teori dhe praktikë në fushat e tyre respektive. Disa nga nevojat më të përmendura për ngritjen e kapaciteteve janë sigurimi i fondeve, legjislacioni tatimor, detyrimet fiskale dhe raportimi financiar, përgatitja e një dokumenti politikash dhe zhvillimi i nismave advokuese.

Hartëzimi i rrjeteve të shoqërisë civile

Ky raport gjithashtu ofron një hartëzim të të gjitha rrjeteve ekzistuese në Shqipëri. Për të gjithë rrjetet e identifikuar, është krijuar një pasaportë individuale e cila përmban informacionin më të rëndësishëm të një rrjeti duke filluar nga: emri i rrjetit; fusha e veprimit; misioni, anëtarësimi, statusi ligjor i rrjetit, statusi aktual i rrjetit (qoftë pasiv ose aktiv), njësia e koordinimit të rrjetit dhe kontaktet e saj.

Hyrja

Qëllimi i Studimit

Fuqizimi i rrjeteve të OSHC-ve është një element i rëndësishëm i punës së Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri. Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë një panoramë të rrjeteve dhe koalicioneve të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, si dhe të vlerësojë kapacitetet e nevojat e tyre për të mbështetur më tej zhvillimin dhe punën e vazhdueshme të rrjeteve e koalicioneve në vend.

Ka një nevojë të madhe për të mësuar më shumë rreth rrjeteve dhe për të kuptuar kontributin që ata mund të japin. Studimi ofron informacione mbi rrjetet dhe eksploron në dinamikën e rrjetëzimit. Ai shtron pyetje dhe çel një diskutim rreth rrjeteve në kontekstin e zhvillimit.

Studimi u udhëhoq nga pyetjet e mëposhtme të hulumtimit:

1. Cilat janë forcat nxitëse dhe drejtuese për formimin e rrjetit?
2. Cilat janë përfitimet që perceptojnë anëtarët që asociohen me rrjetëzimin?
3. Cilat janë sfidat që perceptojnë anëtarët që asociohen me rrjetëzimin?
4. Cilat janë nevojat e anëtarëve të rrjeteve të OSHC-ve për fuqizimin e kapaciteteve?
5. A ekziston një nevojë për krijimin e një rrjeti të ri për të adresuar një temë specifike?
6. Cilat janë boshllëqet në njohuritë tona rreth rrjeteve, dhe cili duhet të jetë drejtimi i praktikave të ardhshme?

Struktura e analizës së hulumtimit

Për këtë studim, fillimisht u analizua konteksti i përgjithshëm në të cilin rrjetet kanë lulëzuar vitet e fundit, madhësinë dhe shtrirjen e tyre si dhe vlerën e rrjeteve në fushën e zhvillimit kombëtar. Së dyti, u analizua marrëdhënia midis menaxhimit të njohurive dhe përhapjes së shpejtë të rrjeteve në ditët e sotme. Meqenëse termi "rrjet" mund të nënkuptojë shumë gjëra për përdorues të ndryshëm, jemi kujdesur veçanërisht të përcaktojmë termat tanë dhe të përpunojmë përkufizimet më të zakonshme që aktualisht janë duke u përdorur në këtë fushë.

Pas këtij informacioni kontekstual, raporti analizon kushtet në të cilat rrjetet kanë tendencë të formohen, përfshirë impulset e jashtme dhe të brendshme dhe formimin bazuar në vizion dhe në vlera. Vlerësimi adreson vazhdimin e evolucionit të rrjetit dhe diskuton ndryshimet në rrjete që evoluojnë në mënyrë organike kundrejt atyre që janë krijuar me qëllim strategjik. Ai gjithashtu hedh dritë mbi faktorët që lidhen me kapitalin social dhe qëndrueshmërinë e rrjetit.

Në përfundim, raporti diskuton përfitimet, sfidat dhe nevojat për programet e ngritjes së kapaciteteve të rrjeteve, bazuar në përgjigjet e drejtuesve të rrjeteve dhe anëtarëve të tyre.

Pasqyrë e Shoqërisë Civile Shqiptare

Sektori i shoqërisë civile në Shqipëri ka shënuar një rritje të konsiderueshme të numrit të OSHC-ve që nga rënia e regjimit komunist. Sektori është zgjeruar shumë dekadat e fundit dhe veprimtaria e tij shtrihet në nivele të ndryshme. Shumica e OSHC-ve janë të vogla dhe shumë prej 10,000+ organizatave të regjistruara janë jo-funksionale dhe pa personel pas emrave kryesorë, duke e bërë të pamundur vazhdimin e veprimtarisë së tyre midis projekteve. Nevojitet ende të zhvillohen lëvizje me baza të forta në komunitete.

Shqipëria ka qenë një kandidat zyrtar për aderimin në Bashkimin Evropian (BE) që nga viti 2014. Në korrik 2016, Shqipëria miratoi një plan gjithëpërfshirës të reformës gjyqësore, i cili përfshin ndryshime legjislativë, institucionale dhe politike. Në Nëntor 2016, Këshilli Evropian rekomandoi me kusht hapjen e bisedimeve të pranimit në BE me Shqipërinë, duke iu nënshtruar përparimit të vazhdueshëm në zbatimin e pesë prioritetëve kryesorë dhe përparimin në zbatimin e reformës në drejtësi. Sipas Raportit të BE-së për Shqipërinë 2018, ende ekziston nevoja për një bashkëpunim dhe koordinim më të ngushtë në të gjitha nivelet e qeverisë me platformat parlamentare dhe të shoqërisë civile që merren me reformat kryesorë dhe çështjet e integritetit në BE. Raporti vë në dukje nevojën për të vazhduar konsultimin publik sistematik dhe transparent me shoqërinë civile në nivelin lokal dhe qendror. Mjedisi fiskal dhe ligjor për shoqërinë civile në Shqipëri kërkon përmirësim pasi qëndrueshmëria financiare e shoqërisë civile mbetet një sfidë.

Komunikimi i vitit 2018 nga Komisioni në Parlamentin Evropian (EU Commission, 2019), Këshill, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve me temë "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për dhe zgjerimin e angazhimit të BE me Ballkanin Perëndimor" (Strategjia e Ballkanit Perëndimor) thekson që qeveritë duhet të sigurojnë që palët e interesuara të kenë mundësinë të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e reformës dhe politikëbërjes. Kjo mund të bëhet për shembull duke krijuar dialog të strukturuar gjithëpërfshirës mbi përparësitë e reformës me përfshirjen e një shoqërie civile të fuqizuar. Prandaj, një mjedis mundësues për organizatat e shoqërisë civile është thelbësor.

OSHC-ve u lejohej të përfshihen në veprimtari ekonomike dhe të gjenerojnë të ardhura përmes kontratave të shërbimit dhe prokurimeve publike. OSHC-të që nuk bëjnë veprimtari ekonomike janë të përjashtuar nga tatimi i vlerës së shtuar (TVSH) në burimet e tyre të të ardhurave jofitimprurëse, përfshirë tarifën e anëtarësisë, fondet, grante dhe donacionet. OSHC-të që merren me veprimtari ekonomike në fushën sociale, arsimore, kulturore ose sportive janë të përjashtuar nga TVSH-ja kur njihen nga autoriteti kompetent në Shqipëri.

Në vitin 2016, aktivizmi qytetar dhe përpjekjet për advokasi adresuan një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit, të drejtat e grave dhe të fëmijëve, reformën në arsimin e lartë, dhe sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë (EU Commission, 2019). Në përgjithësi, OSHC-të në nivel kombëtar kanë kapacitete më të forta advokimi. Kapacitetet e advokimit në nivelin lokal vazhdojnë të jenë të pazhvilluara dhe kërkojnë mbështetje dhe forcim të mëtejshëm

OSHC-të kanë të drejtë të marrin pjesë në prokurimet publike por sipas Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, pjesëmarrja në tenderët publik mbetet shumë e kufizuar kryesisht për shkak të aftësive të kufizuara të OSHC-ve për të përmbushur kërkesat, mungesës së besimit në transparencën e procesit dhe mungesës së një kuadri mbështetës financiar për OSHC-të që ofrojnë shërbime sociale (Partners Albania, 2019).

Kapacitetet përthithëse të OSHC-ve në zonat rurale dhe të largëta mbeten të kufizuara, megjithatë OSHC-të vazhdojnë të përfshihen në krijimin e rrjeteve dhe koalicioneve. Në vitin 2016, disa rrjete aktive, u fokusuan në çështjet e grave dhe fëmijëve, çështjet e të rinjve, të drejtat e LGBTI, reformën në drejtësi dhe çështjet mjedisore (EU Commission, 2019).

Sipas rrjeteve të OSHC-ve pjesë e këtij vlerësimi, mungesa e një sistemi të drejtë drejtësie e që funksionon siç duhet, i lidhur ngushtë dhe i ndikuar nga politika, janë gjithashtu sfida të mëdha me të cilat përballet shoqëria civile shqiptare. Studimet e fundit gjithashtu venë në dukje sfidat e OSHC-ve në nivel vendor për të ushtruar rolin e tyre monitorues dhe për të mbajtur një qëndrim kritik në terma afatgjatë për shkak të presionit politik dhe mungesës së mediave të pavarura. Ndërsa disa organizata më të forta të shoqërisë civile janë prezente dhe aktive, shumë prej tyre nuk kanë kapacitete në fronte të ndryshme. Kapacitetet organizative dhe qeverisja e brendshme shpesh janë të dobëta. Me financim të pasigurt, qarkullimi i stafit brenda organizatave të shoqërisë civile është rrjedhimisht i lartë. Për më tepër, angazhimi i shoqërisë civile në fazën e re të procesit të integritetit në BE është kyç, por shoqëria civile në përgjithësi ka një kuptim të pamjaftueshëm të implikimeve të këtij procesi të pranimit për reformat e vendit. Diskutimet me aktorë të ndryshëm dhe partnerët e OSHC-ve zbulojnë se besimi i publikut në shoqërinë civile është relativisht i ulët dhe OSHC-të shpesh kanë lidhje të dobëta me bazën mbështetëse. Shpesh ka mungesë përfaqësimi dhe aftësi të kufizuar në marrëdhëniet me publikun. OSHC-të shpesh perceptohen si mjete të themeluesve të tyre dhe të lidhura me agjendat politike.

Përcaktimi i rrjeteve dhe koalicioneve të shoqërisë civile

Rrjetet e shoqërisë civile mund të përkufizohen si grupe të shoqërisë civile, organizata dhe ndonjëherë individë që bashkohen vullnetarisht për të ndjekur qëllimet e përbashkëta të zhvillimit shoqëror ose qeverisjes demokratike. Këto qëllime mund të përfshijnë shkëmbimin e burimeve, adresimin e qëllimeve të përbashkëta shoqërore ose shprehjen e identitetit të tyre si bashkësi ose grup shoqëror. Në rrjetet e shoqërisë civile, grupet anëtare dhe organizatat ruajnë autonominë e tyre, me identitetin e tyre, misionin dhe qeverisjen. Rrjetet mund të përbëhen nga marrëdhënie shoqërore joformale ose organe formale që janë regjistruar dhe institucionalizuar ligjërisht. Rrjetet shpesh zgjedhin emrat e tyre bazuar në identitetin, kontekstin dhe gjuhën e tyre (Mona Younis, 2017).

Në botën e OSHC-ve, termi "rrjet" përdoret gjerësisht për të treguar disa individë dhe grupe që punojnë së bashku; dhe këto "nyje" bashkëpunojnë shpesh në bazë të forcave të ndryshme dhe me intensitet të ndryshëm (Fox J, Coalitions and networks: Grassroots movements, NGOs and

local government. Alternatives, 2010). Shpesh, termi rrjet përdoret për të treguar vetëm shpërndarjen ose sekretariatit e rrjetit, ose një organizatë hierarkike anëtarësie. Ky mund të jetë një tregues i zhvendosjes të pushtetit dhe autoritetit - jo domosdoshmërisht i dakortësuar mes të gjithëve – nga nyjet kolektive drejt një qendre administrative që më pas vazhdon të pozicionohet vetë, dhe të veprojë, si "rrjeti".

‘Rrjeti’ dhe “rrjetëzimi” nuk janë e njëjta gjë. Rrjetëzimi nënkupton ose që individët të takohen dhe të mbajnë kontakte për të çuar më tej interesin e tyre ose që organizatat fillojnë të bashkojnë forcat për të adresuar një shqetësim të përbashkët. Kjo gjithashtu mund të quhet "qasje rrjetëzimi", ndërsa një "rrjet" mund të jetë rezultat i këtyre proceseve.

Koalicionet janë partneritete midis aktorëve të veçantë që koordinojnë veprimet në ndjekje të qëllimeve të përbashkëta. Por çfarë i dallon ata nga llojet e tjera të partneriteteve? Termi përdoret gjerësisht për të përshkruar ndërmarrjet e përbashkëta në një gamë të gjerë arenash, veçanërisht në gjeopolitikën ndërkombëtare ose konkurrencën dhe qeverisjen e partive politike. Literatura për koalicionet mbizotërohet nga diskutimet për luftën dhe paqen, fushatat zgjedhore dhe dinamikën parlamentare. Ashtu si në luftë ose politikë, veprimi i suksesshëm kolektiv edhe në shoqërinë civile shpesh varet nga formimi dhe mbijetesa e koalicioneve.

Megjithëse terminologjia ndryshon nga rrjeti në rrjet dhe nga një autor te tjetri, ekzistojnë një seri përcaktimesh, përgjithësisht të përdorura, e që kapin thelbin e formave të rrjeteve që ekzistojnë.

<i>Komunitetet e praktikës</i>
Komunitetet e praktikës janë rrjete të vet-organizuar të organizatave dhe individëve që ndajnë interesa dhe praktika të përbashkëta të punës. Komunitetet e praktikës shpesh fillojnë si shoqata joformale që ofrojnë hapësirë për shkëmbimin e njohurive dhe inkurajimin e ideve të reja. Ato mund të zyrtarizohen me kalimin e kohës me rritjen e shkëmbimeve të rregullta dhe të përfitimeve të perceptuara. Megjithëse shpesh kanë strukturë shumë mundësuese e jo formale, ekziston një rregullsi e natyrshme në komunikimin brenda komuniteteve të praktikës që i dallon ato nga rrjetëzimi i përgjithshëm. Komunitetet e praktikës në përgjithësi nuk përfshihen në veprim kolektiv, kështu që motivimi për pjesëmarrje është zakonisht të krijojë kapacitete individuale për punë individuale (Wenger & McDermott and Snyder, 2002).
<i>Rrjetet sektoriale</i>
Rrjetet sektoriale janë të organizuar rreth një sektori specifik, siç është sektori joqeveritar, mjedisi ose shëndetësia. Ato shpesh janë të iniciuara nga donatorët. Aktivitetet e rrjeteve sektoriale janë të drejtuara drejt përmirësimit të informacionit publik dhe rritjes së ndërgjegjësimit në një sektor të veçantë. Rrjetet sektoriale janë përgjithësisht shumë bashkëpunues dhe shpesh përfshijnë advokim, fuqizim të kapaciteteve teknike, hulumtime të përbashkëta dhe zhvillimin e standardeve (Goodin, 2002).
<i>Rrjetet e ndryshimeve sociale ose të advokimit</i>
Rrjetet e ndryshimeve sociale ose të advokimit, nganjëherë të quajtura aleanca dhe koalicione, krijohen me qëllim të avancimit më tej të çështjeve ose interesave të anëtarëve të rrjetit, shpesh me një synim të qartë. Shpeshherë ky synim lidhet me kushtet sociale në një zonë. Në ndryshim nga llojet e tjera të

rrjeteve, rrjetet e advokimit shpesh angazhojnë drejtpërdrejt institucione qeveritare dhe ndërqeveritare, për të sjellë ndryshimin e dëshiruar. Anëtarësia nuk është e kufizuar vetëm për organizatat, dhe rrjetet përgjithësisht veprojnë si struktura informale (Goodin, 2002) (Ricardo Wilson-Grau & Martha Nuñez, 2007).

Rrjetet e ofrimit të shërbimeve

Rrjetet e ofrimit të shërbimeve përfshijnë organizata autonome që koordinojnë përpjekjet në ofrimin e shërbimeve, përgjithësisht në sektorët e shëndetit dhe shërbimeve sociale. Megjithatë ato zakonisht përbëhen më së shumti nga OSHC, shumica e rrjeteve të ofrimit të shërbimeve financohen me fonde publike. Në lidhje me maksimizimin e shtrirjes dhe ndikimit, koordinimi i shërbimeve në një rrjet ndihmon në rritjen e efikasitetit, redukton mbivendosjet e aktiviteteve dhe zvogëlon konkurrencën.

Hartëzimi i rrjeteve të OSHC-ve në Shqipëri – Pasaportat e rrjeteve

Në këtë vlerësim është paraqitur harta e rrjeteve / koalicioneve të OSHC-ve në Shqipëri që veprojnë në territorin e vendit dhe më gjerë. Bazuar në analizën e të dhënave sekondare dhe gjithashtu në informacionin që Partnerët Shqipëri disponon si pjesë e punës së saj shumëvjeçare në sektorin e shoqërisë civile për fuqizimin e kapaciteteve dhe krijimin e një mjedisi mundësues për OSHC-të, janë identifikuar 27 rrjete, nga të cilat vetëm 33 % janë regjistruar zyrtarisht dhe 67% veprojnë joformalisht. Sa i përket fushës së veprimtarisë ku ata veprojnë, vërehet se fushat kryesore të punës së tyre janë: Çështjet e të Rinjve dhe të Drejtat, si dhe Qeverisja e Mirë dhe të Drejtat e Njeriut respektivisht në 15% të rasteve, e ndjekur nga Çështjet e Mjedisit dhe të Drejtat e Grave në 11% të rasteve.

Që prej fillimit të veprimtarisë së saj, Partnerët Shqipëri ka krijuar Direktorinë e Organizatave të Shoqërisë Civile bazuar në një vlerësim të gjerë në sektor zhvilluar në vitin 2001. Me kalimin e viteve, si pjesë thelbësore e punës së saj si qendër burimore për sektorin, në bashkëpunim me OSHC-të dhe institucionet e tjera në vend, baza e të dhënave është pasuruar më tej me kontakte të përditësuara jo vetëm nga aktiviteti i PA (trajnime, konferenca, takime me OSHC), por edhe nga listat e tjera të institucioneve shtetërore dhe donatorëve në vend.

Sa i përket shtrirjes gjeografike, pothuajse në të gjitha rastet, rrjetet funksionojnë në nivel kombëtar. Vetëm në një rast, një rrjet e ka shtrirë veprimtarinë e tij përtej kufijve të Shqipërisë.

Nëse analizojmë vitin e themelimit të rrjeteve, rrjetet kanë filluar të themelohen në vitin 1999 e në vijim deri në 2017, me një moshë mesatare prej 6 vitesh. Sidoqoftë, duhet të theksohet fakti që ekziston një interes i vazhdueshëm për krijimin e rrjeteve, duke qenë se rrjete të reja vazhdojnë të krijohen. Një fakt tjetër i rëndësishëm i paraqitur në analizën e mëposhtme shpjegon tendencën e organizatave për të formuar rrjete ose koalicione në periudha të caktuara, kryesisht të lidhura me orjentimin e donatorëve dhe statusin specifik të vendit në atë periudhë kohore.

Është me interes të theksohet se rrjetet / koalicionet në shumicën e rasteve kanë në anëtarësi të tyre vetëm OSHC, por ka edhe raste të rrjeteve që kanë si anëtarë një institucion publik (1 rast) dhe donatorë (1 rast).

Në Shtojcën 1 të raportit paraqitet informacion specifik për rrjetet e identifikuar. Për secilin rrjet është krijuar një pasaportë individuale e cila mbart informacionin më të rëndësishëm të një rrjeti, duke filluar nga: emri i rrjetit, fusha e veprimtarisë, misioni, anëtarët, statusi juridik i rrjetit, statusi aktual i rrjetit (pavarësisht nëse ai është pasiv apo aktiv), njësia e koordinimit të rrjetit dhe kontaktet e saj.

Rishikimi i literaturës

Në një rishikim të literaturës së shkencave politike mbi "teorinë e koalicionit dhe formimin e qeverisë", Strøm dhe Nyblade përcaktojnë koalicionet më gjerësisht si "një ekip individësh ose grupesh që bashkohen për një qëllim të përbashkët" (Strøm K & Nyblade B, 2007). Megjithatë, ky formulim është aq i gjerë sa që mund të përshekruajë shumicën e formave të veprimit kolektiv - dhe kështu të bjerë pre e "shtrirjes konceptuale" (Sartori G, 1984). Qartësisht, koalicionet përfshijnë veprim kolektiv, por ato përfshijnë bashkëpunim midis aktorëve që gjithsesi dallohen në një farë mënyre (në të kundërt, për shembull, nga shkrija ose bashkimi). Downs ofron një përkufizim më të saktë të koalicionit: "kur dy ose më shumë grupe politike ose aktorë bien dakord të ndjekin ndonjë objektiv të përbashkët, burimet e grupit...dhe komunikojnë në mënyrë aktive gjatë aksionit të përbashkët" (Downs, 2008). Ai sugjeron që një nga pyetjet më sfiduese përfshin kushtet nën të cilat kundërshtarët ndonjëherë bashkëpunojnë.

Shumë qasje ndaj koalicioneve i referohen bashkëpunimit të bazuar në interes duke përfshirë sjelljen instrumentale, shpesh brenda një horizonti të kufizuar kohor në ndjekjen e qëllimeve të prekshme (p.sh., për të fituar një luftë, një zgjedhje ose për të miratuar legjislacionin) (Diani & McAdam, 2003). Megjithatë, nga pikëpamja e analizës së shoqërisë civile, shumë aktorë që formojnë koalicione, në orientimin e tyre, gjithashtu bazohen në vlera. Këto vlera mund të bien ndesh me disa nga sjelljet instrumentale dhe pabarazitë e fuqisë që shpesh karakterizojnë, për shembull, fushatat afatshkurtra. Kjo qasje e fundit e koalicionit nuk rezonon me foljen "të bashkohemi", që nënkupton të rritemi së bashku - por ajo ngre një nga çështjet kryesore që lind kur merren parasysh koalicionet dhe aleancat (një sinonim ky i përdorur gjerësisht).

Një nga sfidat kryesore në përkufizimin e koalicioneve është mënyra se si t'i dallojmë ato nga rrjetet. Ndër përkufizimet e shumta të rrjetit, pak janë përshtatur për aktorët e shoqërisë civile. Studimi klasik i Keck dhe Sikkink ofron një formulim të përmbledhur: "Rrjetet janë forma të organizimit të karakterizuara nga modele vullnetare, reciproke, dhe horizontale të komunikimit dhe shkëmbimit". Të dy koalicionet dhe rrjetet ndryshojnë në mënyrë empirike përsa i përket shkallëve përkatëse të centralizimit ose decentralizimit (Keck, 1998). Teoricienët organizativë, të cilët i dallojnë rrjetet nga tregjet dhe hierarkitë, do t'i referoheshin koalicioneve si një formë rrjeti. Për aktorët e shoqërisë civile, koalicionet i referohen rrjeteve që janë të angazhuar në veprim të përbashkët. Sipas Keck, "koalicionet janë rrjete në modalitet veprimi" (Fox, 2002).

Koalicionet ndryshojnë nga rrjetet dhe lëvizjet

Në praktikë, ndër diskutimet në shoqërinë civile, termi koalicion shpesh përdoret duke ju referuar lëvizjeve e rrjeteve dhe anasjelltas. Megjithatë, të tre termat nuk janë sinonime, dhe për qëllime analitike është e dobishme të bëhet dallimi midis tyre. Lëvizjet janë gjithmonë të bazuara në rrjetet sociale, megjithëse vetëm disa rrjete krijojnë lëvizje (Diani & McAdam, 2003). Në këtë proces, etiketimet mund të jenë konfuze - disa koalicione të mëdha e konsiderojnë veten si rrjete. Disa rrjete të vogla e konsiderojnë veten si koalicione. Disa koalicione të aktorëve të ndryshëm e

përshkruajnë veten si lëvizje, duke mbivlerësuar shkallën e tyre të kohezionit dhe identitetin e përbashkët kolektiv; nga ana tjetër, disa lëvizje mund të shprehen për veten e tyre si koalicionet organizatash (Sen et al, 2004).

Një mënyrë për të dalluar më qartë ndryshimet midis rrjeteve, koalicioneve dhe lëvizjeve është të konsiderohet secili term duke iu referuar një pike të ndryshme përgjatë një kontinuum-i të shkallëve të ndryshme të densitetit organizativ dhe kohezionit social (Fox J, How does civil society thicken? The political construction of social capital in Rural Mexico, 1996). Për më tepër, koalicionet trans-nacionale përballen me sfida që janë të ngjashme me ato me të cilat përballen koalicionet vendase - veçanërisht për aq sa kalojnë kufijtë e klasës, gjinisë ose racave (Bandy, 2005).

Si rrjetet ashtu dhe koalicionet përfshijnë sisteme të ndërlidhura të komunikimit, duke përgatitur shfaqjen e një sfere publike trans-nacionale. Megjithatë, ndërsa shumë rrjete përfshijnë qëllime të përbashkëta midis anëtarëve të tyre, ato nuk përfshijnë domosdoshmërisht veprim të përbashkët. Pavarësisht nëse rrjetet takohen dhe kryejnë aktivitetin e tyre në terren apo veprojnë virtualisht, ata përfshijnë shkëmbimin e informacionit, përvojave dhe shprehjen e solidaritetit. Ndonjëherë këto shkëmbime gjenerojnë rrjete marrëdhëniesh të vazhdueshme. Ndonjëherë këto rrjete gjenerojnë qëllime të përbashkëta, besim dhe mirëkuptim të ndërsjellë, të nevojshme këto për të formuar koalicionet të afta për të bashkëpunuar në fushata specifike. Por rrjetet jo domosdoshmërisht koordinojnë veprimet e tyre, apo arrijnë marrëveshje për veprime specifike të përbashkëta (siç nënkuptohet nga koncepti i koalicionit).

Rrjetet dhe koalicionet e shoqërisë civile bazohen në interesa si dhe në ide. Rrjetet e advokimit përcaktohen "kryesisht nga qendra e ideve apo vlerave parimore që motivojnë formimin e tyre" (Keck, 1998). Në të vërtetë, shumë marrëdhënie ndërkufitare të shoqërisë civile janë të motivuara nga botëkuptime të përbashkëta.

Gjetjet kryesore

Karakteristikat e Rrjeteve

Ky seksion paraqet gjetjet kryesore nga intervistat e bëra me organizata të cilat në kohën e kryerjes së studimit, kishin rolin e njërive të koordinimit të rrjeteve të përfshira në këtë studim.

Fillimisht analizohet se cilat janë qëllimet e rrjetëzimit bazuar në literaturë dhe të dhënat e disponueshme. Më tej, është analizuar struktura që rrjetet kanë si dhe karakteristikat e tyre. Gjithashtu, janë analizuar dimensionet kryesore të rrjeteve, si: rëndësia e tyre, kapacitetet e rrjeteve, aftësitë e tyre rrjetëzuese, si dhe një përmbledhje e nevojave të këtyre rrjeteve për fuqizimin e kapaciteteve.

Qëllimi i rrjetit

Një mënyrë shumë e dobishme për të bërë dallimin midis llojit të rrjeteve është sipas qëllimit të tyre (asaj çka duan të arrijnë bashkarisht) dhe nivelit të nevojshëm të ndërrarësisë për ta ndjekur atë. Shumica e rrjeteve të shoqërisë civile shfaqin një ose më shumë ndër pesë llojet kryesore të qëllimit të përbashkët. Secili prej këtyre llojeve të qëllimit të përbashkët është i lidhur me një nivel të ndërrarësisë nga e ulët në e lartë.

Pesë llojet e qëllimeve të përbashkëta për rrjetet që ndeshen shpesh midis OSHC-ve në zhvillimin ndërkombëtar përfshijnë:

1. Për të shkëmbyer informacion dhe mësuar nga njëri-tjetri, p.sh., për të mësuar më shumë rreth asaj që po bën secila organizatë, për të shkëmbyer qasjet e programeve dhe për të identifikuar praktikatat më të mira ose për të marrë informacion rreth qasjeve inovative për adresimin e problemeve të ndryshme.
2. Për të koordinuar politikatat, programet ose aktivitetet e tjera, p.sh., për të adresuar çështje të tilla si mbivendosjet apo boshllëqet për të maksimizuar përdorimin e burimeve për qëllime të përbashkëta.
3. Për të marrë fonde të përbashkëta për anëtarët, p.sh., për të rritur burimet e secilit anëtar individual ose për të ndarë fonde mbi baza programatike në një sektor ose me një temë të caktuar, në disa organizata të rrjetit.
4. Për të krijuar një vlerë të re sociale, p.sh., për të realizuar një fushatë advokimi për politika ose ndryshime sociale ose për të zhvilluar programe të përbashkëta për ofrimin e shërbimeve.
5. Për të forcuar identitetin dhe interesat e përbashkëta të anëtarëve në terma afatgjatë, p.sh., për të ndërtuar standarde të sektorit ose për të kontribuar në zhvillimin e legjislacionit që krijon mjedis më mundësues.

Në Shqipëri, shumica e rrjeteve ose koalicioneve të analizuara janë nën kategorinë 4, por jo domosdoshmërisht vetëm në atë kategori. Duke analizuar gjithashtu mënyrën se si janë krijuar

dhe "forcat lëvizëse" që kanë mundësuar krijimin e tyre, arrijmë në përfundimin se një pjesë e madhe e rrjeteve hyjnë në kategorinë 2. Më tej, të gjitha këto rrjete të krijuara e shfrytëzojnë rrjetin për të "shkëmbyer informacion dhe mësuar nga njëri-tjetri".

Një tjetër mekanizëm që ka shërbyer si forcë shtytëse për rrjetëzimin janë organizatat ndërkombëtare, të cilat përmes donatorëve dhe programeve të tyre specifike synojnë forcimin e rolit të shoqërisë civile në tërësi. Midis tyre mund të përmendim USAID, i cili gjatë periudhës së reformës në sistemin e drejtësisë, stimuloi krijimin e një rrjeti të shoqërisë civile me qëllim rritjen e rolit të shoqërisë civile në konceptimin dhe zbatimin e reformës në drejtësi. Gjithashtu Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është një nga mekanizmat që ka mbështetur krijimin e disa rrjeteve të organizatave mjedisore që janë aktive edhe sot.


Ndër të tjera, ekzistojnë rrjete në Shqipëri që kanë si pjesë të rrjetit të tyre, institucione shtetërore ose marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione. Këtu mund të përmendim rrjetin OGP - (Partneritet i Qeverisë së Hapur) i cili funksionon përmes një marrëveshje bashkëpunimi me institucionet shqiptare. Po ashtu mund të përmendim Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Anti-Trafik, një rrjet që ka një institucion publik në anëtarësinë e tij. Marrëdhënie të tilla, përtej anëve pozitive, shpesh herë vendosin në sprovë dhe pengojnë funksionimin e rrjetit kur rrjeti duhet të advokojë për çështje specifike përballë institucioneve shtetërore. Një tjetër pasojë me të cilën duhet të përballen këto rrjete është ndryshimi i shpeshtë i drejtuesve me të cilët ata janë të detyruar të bashkëpunojnë. Në raste të tilla është detyrë e anëtarëve të tjerë që të ndërgjegjësojnë drejtuesit e rinj dhe të kërkojnë angazhimin e tyre në këtë rrjet të institucionit që ata përfaqësojnë.

Struktura

Shumë rrjete në botën e shoqërisë civile janë formale, me një formë ligjore të përshtatshme për organizatat jofitimprurëse, p.sh. një shoqatë, fondacion, ose ndërmarrjeje sociale. Kjo zakonisht nënkupton që qeverisja e tyre bëhet nga një bord i cili jep udhëzime strategjike për ata që menaxhojnë rrjetin si dhe monitoron dhe kontrollon zbatimin e tyre dhe veprimtarinë e rrjetit. Gjithashtu, rrjetet e OSHC-ve shpesh janë organizata me anëtarësi, anëtarësi që nga individë dhe organizata të vetme, deri në 'organizata ombrellë', p.sh. platforma ndërkombëtare që përbëhen nga platforma kombëtare. Por gjithashtu ekzistojnë shumë rrjete që janë informale, të cilat kanë vendimmarrje të përbashkët por nuk kanë sekretariat, ose një sekretariat të vendosur përkohësisht ose mbi baza rotacioni tek një partner i rrjetit.


Nga rrjetet e intervistuar, 52% e tyre deklaruan se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë informale dhe vetëm 43% formale (rrjete të regjistruar ligjërisht). Këto shifra i atribuohen faktit se në Shqipëri shumica e organizimeve janë rrjete informale që veprojnë mbi baza vullnetare pa ndonjë angazhim të shkruar për anëtarët. Vetëm një ndër rrjetet e intervistuar rezulton të jetë me status të pezulluar dhe për riaktivizimin e tij do nevojitej proces gjyqësor.

Në rastin e rrjeteve të regjistruara, një pjesë e respondentëve deklaruan se ata janë regjistruar ligjërisht si nisma specifike të donatorëve që preferojnë të bashkëpunojnë me rrjete formale në mënyrë që ata t'i mbështesin përmes skemave të financimit.



Të pyetur në lidhje me mënyrën se si këto rrjete rregullojnë marrëdhëniet e tyre midis anëtarëve, 75% e tyre u shprehën se ekziston një rregullore e brendshme e dakordësuar që përcakton qartë marrëdhëniet midis anëtarëve dhe palëve të treta, edhe pse në shumicën e rasteve nuk ekziston një marrëveshje me shkrim. Nga ana tjetër, 25% e respondentëve shprehen se nuk kanë një rregullore të tillë. Nga intervistat e kryera është e qartë se çdo rrjet natyrshëm ka gjetur mënyrën e tij të organizimit që sipas tyre është më e përshtatshme, duke marrë parasysh angazhimin e anëtarësisë së tyre. Sipas të dhënave të vlerësimit, rezultoi se 90% e rrjeteve nuk kanë sekretariat teknik, vetëm 10% e tyre deklarojnë se e kanë një të tillë. Të ndeshur në shumë vështirësi për çështje organizative të aktiviteteve të rrjetit, respondentët theksuan rëndësinë e një sekretariati teknik që do të mundësonte koordinimin e të gjitha aktiviteteve të rrjetit. Ata argumentojnë se një organizim i tillë do të rriste aktivizimin dhe efikasitetin e rrjetit si dhe do të rregullonte qartazi marrëdhëniet midis anëtarëve.

Grafiku 2
Rregullore e brendshme



Për të krijuar një pamje më të qartë se si funksionojnë këto rregullore të brendshme, respondentët u pyetën nëse këto rregullore zbatohen realisht dhe nëse ato inkurajojnë anëtarët të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes.

Në shumicën e rasteve, edhe kur nuk ka rregullore të brendshme, rrjetet deklarojnë se zbatohen disa rregulla të funksionimit, joformale, e mbi të cilat të gjithë anëtarët kanë rënë paraprakisht dakord. Sa i përket inkurajimit të anëtarëve në proceset vendimmarrëse, në 80% të rasteve respondentët deklaruan se këto procese inkurajojnë anëtarët që të marrin pjesë në këto procese, veçanërisht ata anëtarë që janë vërtetë aktivë dhe kontribuojnë në rrjet.

Pjesa dërmuese e rrjeteve deklaruan që kanë një bord drejtues funksional përmes të cilit miratohen të gjitha vendimet që lidhen me veprimtarinë e rrjetit. Anëtarët pranojnë se në secilin rrjet ka disa organizata anëtare që luajnë rol kryesor dhe kryejnë pjesën më të madhe të punës në rrjet, por kjo jo domosdoshmërisht përkthehet në një "protagonizëm individual të një organizate".


Nga ana tjetër, konfirmohet gjithashtu se një numër i konsiderueshëm i anëtarëve e shikojnë angazhimin në procesin e vendimmarrjes me indiferentizëm.

Sa i përket anëtarësimit gjithëpërfshirës të rrjeteve dhe koalicioneve të përfshira në vlerësim, vlen të përmendet se të gjitha rrjetet janë gjithëpërfshirëse dhe kanë në anëtarësimin e tyre burra dhe gra.

Shumica dërmuese (75%) e tyre deklaruan se pjesë e antarësive të tyre janë të rinj dhe gra, një tregues shumë i rëndësishëm i rrjeteve të shëndetshëm. Në 20% të rasteve, rrjetet deklarojnë që kanë vetëm gra në anëtarësinë e tyre, si rezultat i fokusit të punës së tyre i cili është i orientuar tërësisht tek vajzat dhe gratë. Vetëm 5% e rrjeteve kanë vetëm të rinj në anëtarësimin e tyre.

Antarësimi i rasteve të sipërpërmendura, është rezultat i fushës së ngushtë të veprimit të vetë këtyre organizatave, pa ndonjë arsye specifike ose diskriminuese.

Sa i përket antarësimit gjithëpërfshirës të rrjeteve dhe koalicioneve të përfshira në vlerësim, 75% e tyre deklaruan se ata kanë në antarësimin e tyre të rinj dhe gra, një tregues shumë i rëndësishëm i shëndetit të rrjetit. Sidoqoftë, në 20% të rasteve, rrjetet deklarojnë se ato kanë vetëm gra në antarësinë e tyre, kjo si rezultat i fokusit të orientuar në punën e tyre i cili është tërësisht i orientuar tek gratë. Ndërsa vetëm 5% e rasteve rezultojnë që këto rrjete kanë vetëm të rinj në antarësimin e tyre. Rastet e segreguara të antarësimit vijnë nga fusha e veprimtarisë së vetë këtyre organizatave, pa ndonjë arsye specifike ose diskriminuese.



Në aspektin gjeografik, rrjetet e OSHC-ve që kanë shtrirë veprimtarinë e tyre në mbarë vendin ose edhe tërë rajonin janë gjithnjë e më të zakonshme. Antarësia e tyre shpesh është e karakterit lokal, kombëtar, rajonal ose një kombinim i tyre. Për më tepër, lidhjet midis antarëve të ndryshëm mund të tregojnë për shkallë të ndryshme të forcës, sipas asaj fushe ku preferojnë të angazhohen dhe atyre gjërave që janë në gjendje të bëjnë.

Shpërndarja gjeografike konsiderohet gjithashtu si një nga atributet kryesore që tregon fuqinë dhe potencialin e një rrjeti të organizatave, megjithëse jo domosdoshmërisht pasi fokusi i veprimtarisë së rrjetit duhet të merret në konsideratë. Nga intervistat e kryera me rrjetet e përfshira në vlerësim, 75% e tyre e kanë shtrirë veprimtarinë e tyre në më shumë se 3 qytete të Shqipërisë, ndërsa vetëm 25% e tyre janë përqendruar në 1-3 qytete. Vetëm në 3 raste, rrjetet ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të 12 qarqet e vendit. Njësitë e koordinimit të rrjeteve janë në Tiranë, për faktin se politikat advokohen kryesisht me qeverinë qendrore. Rrjetet, bazuar në

fushën e punës së tyre, kanë bërë pjesë të anëtarësive, organizata që janë plotësuese dhe në funksion të misionit të rrjetit.

Grafiku 4
Shpërndarja gjeografike



Dimensionet e rëndësishme

Mënyra se si një rrjet është strukturuar mund të hedhë dritë mbi mënyrën se si funksionon në praktikë, megjithëse jo gjithnjë është ky rasti. Mjaft rrjete janë studiuar, vlerësuar dhe dokumentuar me qëllim që të kuptohet se si funksionojnë rrjetet dhe kjo ka ofruar të dhëna shumë të dobishme të cilat paraqiten si më poshtë në këtë seksion. Të gjitha llojet e aspekteve të rrjetit janë hulumtuar nga akademikë, ekspertë, vlerësues, aktivistë, konsulentë dhe donatorë, duke i parë rrjetet nga këndvështrime të ndryshme dhe duke studiuar dimensionet e ndryshme të tyre. Për donatorët dhe vlerësuesit në veçanti, dimensionet më të rëndësishme janë:

- a) Faktorët nxitës dhe drejtues të Rrjetëzimit
- b) Relevanca
- c) Kapacitetet
- d) Rrjetëzimi
- e) Anëtarësia

Këto dimensionet duhet të merren në konsideratë për të arritur në rekomandime konkrete dhe / ose zgjedhje të arsyetuara në lidhje me të ardhmen e këtyre rrjeteve.

Faktorët nxitës dhe drejtues të Rrjetëzimit

Në literaturën për rrjetet përmenden faktorë të ndryshëm që nxisin krijimin e rrjetit. Ata mund të jenë kontekstualë (social, kulturor, teknologjik, ekonomik, mjedisor, politik) ose/dhe situacionalë (çështje specifike për tu adresuar, fondet në dispozicion, autoritetet publike që janë të interesuar për ekzistencën e rrjetit, aspiratat e individëve të caktuar dhe forca e tyre bindëse) (Strøm K & Nyblade B, 2007). Faktorët nxitës më të rëndësishëm kontekstualë përcjellin idenë që:

- Ndryshimi i qëndrueshëm shpesh kërkon bashkëpunim në rrjete, koalicione dhe aleanca;
- Globalizim do të thotë veprim për ndryshim, dhe për këtë arsye struktura dhe qeverisja gjithashtu, shpesh duhet të shkojnë përtej kufijve të organizatës;
- Ndërlidhja midis interesave të ndryshme kërkon punë në rrjete, nga një këndvështrim pozitiv (është mundësi për OSHC-të).

Formimi i rrjeteve të OSHC-ve gjithashtu mund të nxitet nga faktorë situacionalë, siç janë:

- Kërkesat e donatorëve;
- Qëllimet e përbashkëta;
- Interesat personale;
- Përfitimet e pritura.

Në këtë drejtim, faktorët nxitës të rrjetëzimit të OSHC-ve nuk janë të ndryshëm në thelb nga ata të krijimit të çdo organizate tjetër të shoqërisë civile.

Edhe pse në Shqipëri, në praktikë, faktorët nxitës kryesorë janë situacionalë, përgjithësisht është e gjithëpranuar që do duhej të ishin faktorët kontekstualë faktorët nxitës për krijimin e rrjetit.

Nga intervistat e kryera si pjesë e këtij vlerësimi, rezulton se 30% e rrjeteve kanë si faktorë nxitës - Kërkesat e donatorëve dhe Përfitimet e pritura, megjithëse respondentët nuk shprehen drejtpërdrejtë. Fusha e veprimtarisë së këtyre rrjeteve varion, si p.sh.: Mjedisi, Barazia Gjinore, Anti-korrupsioni & Qeverisja e Mirë, dhe Rinia.

Nga ana tjetër, 70% e rrjeteve deklarojnë se kanë pasur si faktorë nxitës - Qëllimet e Përbashkëta dhe Përfitimet e Pritura. Fusha e veprimtarisë së këtyre rrjeteve po ashtu varion si p.sh.: Mjedisi, Barazia Gjinore, Ofrimi i shërbimeve etj.


Relevanca

Meqenëse rrjetet janë grupime vullnetare për të arritur qëllime të përbashkëta, shumë studiues ngrenë pyetje mbi rëndësinë e rrjeteve, për sa i përket vlerës së shtuar të tyre si p.sh. suksesi në arritjen e qëllimeve, që do të ishte e vështirë ose e pamundura për t'u arritur nga anëtarët individualisht. Kjo ngre pikëpyetje mbi dublikimin p.sh. nëse puna që rrjetet po bëjnë është diçka që të tjerët nuk janë duke e bërë, si dhe mbi impaktin p.sh. nëse këto rrjete shtojnë diçka specifike dhe që identifikohet që është ndikim i punës së tyre, dhe nëse këto arritje janë ato që rrjetet kishin për qëllim që prej krijimit të tyre.


Të pyetur nëse rrjeti në të cilin bënin pjesë i ka arritur qëllimet dhe objektivat strategjike për të cilët u krijua, 45% e respondentëve shprehën me bindje që rrjeti i ka arritur qëllimet për të cilat është krijuar dhe po punon në vazhdimësi duke advokuar për disa çështje specifike. Nga ana tjetër, 45% e respondentëve deklaruan se rrjeti ka përmbushur një pjesë të asaj çka synonte dhe

se po punon në vijimësi për të përmbushur objektivat e tjera. Vetëm 10% e tyre deklaruan se rrjeti i tyre nuk ka arritur asnjë nga qëllimet e tij.

Grafiku 5
A po i përmbush rrjeti qëllimet dhe objektivat strategjik për të cilin u krijua?



Të pyetur nëse rrjeti në të cilin ata bënin pjesë, ishte një vlerë e shtuar për anëtarët duke i ndihmuar të arrijnë diçka që ata secili më vete nuk do të ishin në gjendje të arrinin, në 68% të rasteve u deklarua se rrjeti ishte vlerë e shtuar dhe se anëtarët janë duke punuar së bashku për të advokuar për çështje të përbashkëta. Në 16% të rasteve anëtarët e rrjetit kanë shkuar përtej kësaj, duke zgjeruar bashkëpunimin e tyre në zbatimin e projekteve të përbashkëta. Ndërkohë në 12% të rasteve anëtarët deklarojnë se nuk kanë përfutur shumë nga të qenit pjesë e rrjetit p.sh. kanë shkëmbyer informacion për çështje të caktuara, e gjëra të ngjashme si kjo, por jo më shumë. Sipas tyre, kjo është për shkak të mungesës së burimeve financiare të rrjetit dhe të organizatave, çka rrjedhimisht përkthehet në një angazhim në nivele të ulta të tyre. Nga ana tjetër, një numër i konsiderueshëm i rrjeteve të intervistuar (40% të rasteve) deklarojnë se rrjeti me të cilin ata janë anëtarësuar nuk u ka ofruar ndonjë vlerë të shtuar anëtarëve të tij.




Kapacitetet


Një rrjet i organizatave të shoqërisë civile është po aq i fortë sa janë organizatat anëtare të tij. Në kulturën e rrjeteve është e zakonshme që rrjetet të fuqizojnë kapacitetet e organizatave të tyre anëtare dhe rrjedhimisht rrjetin në tërësi.

Të pyetur nëse rrjetet kanë aftësitë e duhura për të zhvilluar kapacitetet dhe aftësitë e anëtarëve të tyre, 70% e tyre deklarojnë se rrjeti i zotëron këto aftësi edhe pse në shumicën e rasteve ky nuk ka qenë qëllimi i rrjeteve dhe për rrjedhojë nuk është parë me prioritet. Ndërkohë, 30% e tyre shprehen se deri diku i zotërojnë këto aftësi, e në mënyrë specifike vetëm në fushat e tyre të ekspertizës. Për më tepër, rrjetet e intervistuar deklaruan se në 85% të rasteve aftësitë dhe kapacitetet e anëtarëve janë rritur në krahasim me periudhën kur ata janë bërë anëtarë të rrjetit.

Grafiku 7
A ka Rrjeti aftësitë e duhura për të zhvilluar kapacitetet e anëtarëve të tij?




Grafiku 8
A janë zhvilluar kapacitetet e anëtarëve?



Për të kuptuar më shumë rreth rasteve kur deklarohet që janë rritur kapacitetet e anëtarëve të rrjetit, është analizuar po ashtu edhe metoda apo instrumenti përmes të cilit është arritur ky qëllim. Në 38% të rasteve deklarohet se kapacitetet e anëtarëve janë rritur përmes trajnimeve të ofruara nga vetë rrjeti / koalicioni, një tregues ky shumë i mirë i qëndrueshmërisë së rrjeteve që investojnë në kapacitetin e anëtarësisë së tyre. Në 31% të rasteve deklarohet se anëtarët kanë rritur kapacitetet e tyre duke shkëmbyer përvoja me anëtarët e tjerë të rrjetit. Ajo që vlen të theksohet është se 19% e tyre deklaruan gjithashtu se kanë ndjekur trajnime të ofruara nga rrjete/koalicione të tjera me të cilat bashkëpunojnë, por që bashkëpunimi është i kufizuar në tema specifike. Një nga praktikatat më të mira të raportuara nga rrjetet lidhur me këtë, është shkëmbimi i përvojave me organizata të tjera dhe vizitat studimore të kryera në kontekstin e projekteve specifike.

Grafiku 9
Si janë zhvilluar kapacitetet e anëtarëve?



Anëtarësia


Për të analizuar rolin e secilit anëtar në një rrjet organizatash, duke identifikuar përfitimet e tij nga rrjeti dhe anasjelltas, ky seksion synon të identifikojë cilat janë përfitimet dhe sfidat e të punuarit së bashku në një rrjet. Gjithashtu synon të vlerësojë kontributin e secilit rrjet në terma rrjetëzimi dhe në rast se rrjeti ka siguruar mundësi të mjaftueshme rrjetëzimi për anëtarët e tij.

Të bërit bashkë e shumë palëve të interesuara me ekspertiza dhe perspektiva të ndryshme, për të arritur qëllimet e përbashkëta, është diçka e mençur, por shpeshherë e vështirë për t'u realizuar. Edhe nëse qëllimi i rrjetit kuptohet gjerësisht kur një grup mbledhet për herë të parë, mund të jetë e vështirë të kuptohet dhe vendoset se nga ku duhet filluar me trajtimin e çështjes në fjalë. Në momentin që fillon, ndodh shpesh që rrjeti të përballlet me sfida dhe barriera në realizimin e planit të tij strategjik.

Një nga sfidat më të mëdha për rrjetet dhe koalicionet rezulton të jetë mungesa e gatishmërisë së anëtarëve për t'u angazhuar në aktivitetin e rrjetit (36% e respondentëve). Rrjetet përmendin gjithashtu probleme të tjera organizative që vijnë nga mungesa e financimit ku në shumë raste është identifikuar si problem shpërndarja gjeografike e anëtarëve të rrjetit sepse ndikon drejtpërsëdrejti në mos marrjen pjesë në takimet e planifikuara të rrjetit. Në 31% të rasteve, u deklarua se mungesa e fondeve për të mbështetur aktivitetet e rrjetit është sfida më e madhe me të cilën përballen. Pjesëmarrësit në vlerësim deklaruan se rrjetëzimi kërkon një angazhim të lartë dhe shpeshherë puna në rrjet kthehet parësore duke preluar mbi punën e përditshme (duke e lënë mënjanë punën e tyre në organizatë), edhe pse nuk mbështetet financiarisht. I gjithë ky angazhim përkthehet në investim në burimet njerëzore dhe janë organizatat e vogla ato që e ndiejnë barrën më të madhe në këtë pikë. Duke marrë parasysh faktin se disa nga rrjetet kanë si forcë nxitëse rrjetëzimi kërkesën e donatorit, disa koordinatorë të rrjetit me të drejtë deklarojnë se kjo ka ndikuar negativisht tek anëtarët e tyre, duke qenë se ata e konsiderojnë rrjetin thjesht dhe vetëm si një burim financimi.


Një sfidë tjetër e rrjeteve dhe koalicioneve, shprehur në 22% të rasteve, është mungesa e gatishmërisë së disa anëtarëve për të bashkëpunuar. Në secilin nga rrjetet e intervistuar thuhet se në përbërjen e tyre ka organizata që kanë mungesë të theksuar të gatishmërisë për të bashkëpunuar dhe ky fakt bëhet pengesë për funksionimin e rrjetit. Nga ana tjetër, dëshira për protagonizëm nga ana e disa anëtarëve perceptohet si sfidë në 17% të rasteve. Ka rrjete që në anëtarësinë e tyre kanë organizata donatore, që janë relativisht më të fuqishme se anëtarët e tjerë. Ky ndryshim, si në aspektin financiar ashtu edhe në potencialin për të ndikuar në institucionet qeveritare përkthehet në shtypjen e anëtarëve të tjerë pasi kjo pjesë e anëtarësisë merr një rol protagonist.

Grafiku 10
Cilat janë sfidat e të punuarit në rrjet/koalicion?



Të pyetur në lidhje me përfitimet e tyre nga rrjeti, shumica e të anketuarve (53%) deklaruan se përfitimi më i madh që ata kanë patur nga rrjeti është *ndikimi më i madh* dhe një *mbrojtje më e mirë nga faktorët e jashtëm*. Në 28% të rasteve, organizatat deklarojnë se përfitimi i të qenit pjesë e rrjetit është një sinergji më e madhe në advokimin për çështje të përbashketa dhe shmangia e mbivendosjes së aktiviteteve të njëjta ose të ngjashme. Vetëm 8% e respondentëve konsiderojnë si përfitim aksesin më të lartë në fonde, kjo edhe për shkak të fondeve të pakta që donatorët kanë për rrjetet, si pjesë e fushave të tyre programatike.

Grafiku 11
Cilat janë përfitimet e të qenit në rrjet/koalicion?



Rrjetëzimi


Rrjetet e intervistuaras u kërkuar të vlerësonin aftësinë dhe kontributin e rrjetit për një rrjetëzim më të mirë të anëtarëve të tij.

Në një vlerësim prej 1 deri në 5, ku 1 tregon që rrjetëzimi i ofruar nga rrjeti konsiderohet jo i vlefshëm dhe 5 do të thotë shumë i vlefshëm, kemi një vlerësim mesatar prej 4.1, vlerësim relativisht i lartë ky, që nënkupton që rrjetet në shumicën e rasteve kanë përmbushur një nga funksionet themelore të tyre që është rrjetëzimi. Dhe kjo nuk është vetëm në rrjetëzim brenda të njëjtit rrjet, por edhe me rrjete të tjera, si dhe me donatorë të rëndësishëm, që në kushte të tjera këto organizata nuk do të mund t'i kishin njohur ose ndërvepruar me ta.

Grafiku 12
Në një shkallë nga 1-5, sa të vlefshme do t'i vlerësonit lidhjet që mundëson rrjeti?



Lidhur me angazhimin e anëtarëve në veprimtarinë e rrjetit dhe mënyrën se si kontribuojnë në rrjet, 55% e respondentëve deklaruan se kontribuojnë së bashku për të arritur qëllimin dhe se nuk ka dallime në nivelin e angazhimit në rrjet. Ndërsa 40% e tyre shprehen se si në çdo bashkëpunim, ka një pjesë kryesore të anëtarëve që kontribuojnë në pjesën më të madhe të punës ndërsa pjesa tjetër është inaktive. Në rastet kur anëtarësimi në rrjet është heterogjen dhe në anëtarësinë e tij nuk ka vetëm organizata të shoqërisë civile, por edhe donatorë, si dhe/ose institucione shtetërore, kjo marrëdhënie ndërlikohet kur diskutohet për kushtet e angazhimit në rrjet. Anëtarët e këtyre rrjeteve deklarojnë se shpeshherë prania e këtyre anëtarëve shndërrohet në pengesë dhe shkakton konfuzion në lidhje me punën e rrjetit në tërësi.



Situata e rrjeteve dhe perspektivat e ardhshme

Të qenit pjesë e rrjetit është pranuar gjerësisht nga të gjitha organizatat si një tregues i rëndësishëm në qëndrueshmërinë e punës së tyre dhe si një faktor i rëndësishëm në çuarjen përpara të nismave advokuese.

Për të vlerësuar nevojat e rrjeteve në tërësi dhe anëtarëve në veçanti, respondentëve iu kërkua të vlerësonin nëse rrjeti ku ata bëjnë pjesë duhet të ndryshojë ose nëse duhet të përmirësojë ndonjë aspekt të tij. Në 95% të rasteve, rrjetet deklaruan se ata kishin nevojë për të ndryshuar ose përmirësuar disa aspekte të rrjetit të tyre dhe vetëm 5% deklaruan se nuk do të ndryshonin asgjë.

Për pjesën më të madhe të rrjeteve e koalicioneve, nevoja për të rritur kapacitetet e anëtarëve të tyre shihet si thelbësore dhe konsiderohet si prioriteti i tyre më i lartë. Për më tej, rrjetet deklarojnë se ata duhet të ndryshojnë mënyrën e funksionimit ose të organizimit, dhe disa rrjete kërkojnë specifikisht krijimin e sekretariatit që do të funksionojë si njësi koordinuese për të gjithë rrjetin. Në këtë mënyrë ata deklarojnë se angazhimi në rrjet do të rritet dhe anëtarët do të kenë më shumë kohë për t'u përfshirë në projektet e tyre individuale.

Në disa raste rrjetet theksojnë nevojën për të patur një legjislacion specifik për njohjen e rrjetit pasi ata e vlerësojnë formalizim si të nevojshëm, por nuk mendojnë se regjistrimi si shoqatë do të ishte i përshtatshëm për ta. Rrjetet gjithashtu deklarojnë se marrëdhëniet me publikun së bashku me publikimin e raporteve vjetore janë shumë të rëndësishme në mënyrë që të njihet e promovohet puna që rrjetet bëjnë.

Grafiku 14

Në rrjetin/koalicionin ku ju bëni pjesë, a e shikoni të nevojshme për të ndryshuar/përmirësuar ndonjë aspekt të tij?



Në vijim të identifikimit të nevojave të rrjeteve për të përmirësuar ose ndryshuar ndonjë aspekt të rrjetit, rezulton që fuqizimi i kapaciteteve të anëtarëve të rrjetit mbetet prioriteti kryesor për ta.

Për këtë qëllim, rrjeteve iu kërkua të vet-identifikojnë nevojat e tyre për tema specifike mbi të cilat ata mendonin se kishin realisht nevojë për të fuqizuar kapacitetet e tyre.

Siç u përmend në analizën e mësipërme, në 20% të rasteve, Ngritja e Fondeve është deklaruar të jetë aspekti më i rëndësishëm mbi të cilin ata duan të fuqizojnë kapacitetet e anëtarëve të tyre. Nevoja për të krijuar një qendrueshmëri më të mirë financiare duket se është mbi çdo çështje apo shqetësim tjetër të rrjetit.


Në vend të dytë, me 12% të rasteve renditen nevojat për fuqizim kapacitetesh në: Legjislacionin Tatimor, Detyrimet Fiskale dhe Raportimin Financiar. Rrjetet shpesh kanë deklaruar që anëtarët e tyre nuk kanë aftësi të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet fiskale dhe ligjore në kontekstin e raportimit financiar dhe shpesh kanë patur eksperiencë të vështira në zbatimin e projekteve të përbashkëta.

Një nga funksionet më të rëndësishme të rrjeteve është ofrimi i rekomandimeve konkrete për politika ose probleme të ndryshme të identifikuara dhe më pas advokimi i tyre në nivelin qendror ose vendor në varësi të çështjes për të cilën advokohet. Kjo është dhe arsyeja që hartimi i një dokumenti politikash, advokacia dhe lobimi renditen në vendin e tretë dhe të katërt të nevojave, përkatësisht me 8% dhe 7% të rasteve.

Tema të tjera që janë me interes për rrjetet dhe organizatat anëtare janë: Komunikimi Efektiv, Zhvillimi i Projekt Propozimeve sipas formateve të BE-së, dhe Menaxhimi i Projektit. Janë

pikërisht këto nevoja dhe adresimi i tyre që shihen si strategjike për qendrueshmërinë e rrjeteve dhe vazhdimësinë e tyre.

Siç rezultoi nga vlerësimi, qendrueshmëria financiare mbizotëron si çështje shqetësuese për të gjitha rrjetet. Asnjë nga rrjetet nuk deklaroi të ketë një plan strategjik i cili siguron bazat dhe strukturën për të ndjekur një vizion më të madh, udhëheq rrjetin në veprimtarinë e tij dhe zbatimin e aktiviteteve, si dhe maksimizon mundësitë për të ndikuar më shumë në mjedisin ku rrjetet veprojnë.




Përveç rrjeteve ekzistuese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri, ky vlerësim synon gjithashtu të vlerësojë aftësinë ose interesin e organizatave për të marrë pjesë ose për tu bashkuar në ndonjë rrjet në nivel kombëtar ose vendor për të punuar mbi një çështje të veçantë e cila sipas perceptimit të tyre duhet adresuar.

Në 65% të rasteve, organizatat kanë treguar që janë të gatshme të bashkohen me një grup të ri për të advokuar për çështje specifike. 20% e tyre deklaruan se nuk kanë interes dhe 10% e tyre nuk pranuan ti përgjigjen kësaj pyetjeje.

Grafiku 16

A do të ishit të interesuar të merrnit pjesë në koalicion apo grup organizatash në nivel kombëtar ose lokal për të adresuar një çështje të caktuar?




Në vijim të shprehjes së interesit për t'u bërë pjesë e një rrjeti për të adresuar specifikisht një çështje të rëndësishme për to, organizatat listuan fushat në të cilat do të donin të punonin për advokimin e çështjeve të caktuara. Përgjigjet e rrjeteve janë të organizuara në 6 kategori kryesore. Me interes më të lartë renditen integrimi i grupeve të marginalizuara dhe pakicave kombëtare, si dhe legjislacioni për OSHC, respektivisht në 18% të rasteve. Më pas, ndër më të përmendurat është barazia gjinore së bashku me mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe fuqizimi ekonomik i tyre, respektivisht në 16% të rasteve.

Antikorrupsioni dhe qeverisja e mirë si dhe procesi i integritetit në BE janë çështjet që renditen në vijim, me më pak interes krahasimisht me të tjerat përmendur më lart (respektivisht në 13% të rasteve).

Grafiku 17

Në cilën fushë programatikë do të ishit të interesuar speifikisht?



Konkluzione

Demokracia e brendshme / struktura e qeverisjes dhe proceset / transparencia organizative:

Kapaciteti i rrjeteve në lidhje me qeverisjen organizative/demokracinë e brendshme vlerësohet si i ulët nga rrjetet pjesë e këtij vlerësimi. Kjo tregon se ka më shumë punë për të bërë në këtë drejtim. Të dhënat e mbledhura nga faqet e internetit të rrjeteve tregojnë që transparencia organizative është gjithashtu e ulët. Edhe kjo është një fushë, e cila meriton angazhim dhe investim më të madh.

Fuqizimi i Kapaciteteve: Rrjetet identifikojnë më së shumti mungesë kapacitetesh për çështje të tilla si ngritja e fondeve, analiza e politikave, legjisllacioni tatimor, detyrimet fiskale dhe raportimi financiar, përgatitja e një dokumenti politikash dhe zhvillimi i nismave advokuese. Dëshira për të fuqizuar kapacitetet për këto çështje u shpreh në pjesën më të madhe të intervistave të kryera si pjesë e këtij vlerësimi. Pranimi i këtyre nevojave dhe identifikimi i vështirësive në këto fusha, mund të vlerësohet si një tregues i pjekurisë organizative. Për të qenë sa më relevant në një kontekst ku i) korniza institucionale dalëngadalë po krijon hapësirë për një rol për shoqërinë civile; dhe ii) angazhimi i shoqërisë civile në fazat e ardhshme të procesit të integritetit në BE është kritik; është e rëndësishme rritja e kapaciteteve të rrjeteve të OSHC-ve për të kryer analiza të politikave dhe për të kuptuar implikimin e procesit të pranimit në BE dhe kontribuar në të.

Rrjetëzimi lokal: Ndërsa organizata në nivel kombëtar dhe/apo në disa prefekturave zhvillojnë partneritete dhe formojnë rrjete e koalicione, jashtë Tiranës, rrjetet midis OSHC-ve në nivelin lokal janë përgjithësisht të dobëta. OSHC-të lokale kanë mungesë kapacitetesh për t'u rrjetëzuar dhe bashkëvepruar në nivel lokal. Ka shumë pak rrjete që ndërveprojnë rregullisht në nivel lokal. Duke marrë parasysh faktin se për politikën advokohet kryesisht në nivel qendror, rrjetëzimi në nivel lokal ka kaluar në vend të dytë, por në fakt është ky lloj rrjetëzimi që ushqen rrjetin me ide dhe çështje për të cilat është e nevojshme të advokohet. Me rritjen e kompetencave të qeverisjes vendore, rritet dhe nevoja për aktivizëm dhe advokim nga OSHC-të në nivel lokal. Forcimi i aftësisë së OSHC-ve për të bashkëpunuar për çështje lokale mbetet thelbësor.

Rrjetëzimi ndërkombëtar: Të gjitha rrjetet e koalicionet ndjejnë nevojën për më shumë rrjetëzim në nivel ndërkombëtar. Deri në një farë mase, kjo mund të jetë një dëshirë për të udhëtuar dhe për të patur eksperiencë të reja dhe / ose një reflektim i dëshirës për të qenë pjesë e Evropës. Megjithatë, disa prej rrjeteve pjesë e vlerësimit, shprehën vërtetë interes të madh dhe motivim për t'u lidhur me OSHC-të evropiane për të shkëmbyer ide, për të punuar së bashku në projekte ndërkufitare, si dhe për të mësuar dhe aplikuar qasje të provuara e për të shmangur dështime të panevojshme.

Qendrueshmëria: Pothuajse të gjitha rrjetet e OSHC-ve nuk kanë plane strategjike të cilat do të ofronin bazën dhe strukturën për të ndjekur një vizion më të madh, për të udhëhequr rrjetin në veprimtarinë e tij dhe zbatimin e aktiviteteve, si dhe për të maksimizuar mundësitë për të ndikuar më shumë në mjedisin ku rrjetet veprojnë. Qendrueshmëria financiare mbizotëron si çështje shqetësuese për të gjitha rrjetet. Rrjetet e OSHC-ve po përpiqen të gjejnë burime financimi për kostot bazë dhe aktivitetet, dhe varen shumë nga financimi i projekteve dhe donatorët, veçanërisht nga Bashkimi Evropian. Në përgjithësi, rrjetet dhe koalicionet pjesë e vlerësimit, mendojnë se kanë mbetur mbrapa për sa i përket kapacitetit, kohës dhe burimeve për t'iu përgjigjur tendencave në ngritjen e fondeve dhe gjenerimin e të ardhurave. Tendenca të tilla mund të jenë sfida për rrjetet e koalicionet, e nëse trajtohen si duhet, mund të jenë sa sfida edhe mundësi për to. Qendrueshmëria e rrjeteve është e lidhur drejtpërdrejt me qendrueshmërinë dhe kapacitetin e organizatave anëtare; prandaj forcimi i mëtejshëm i OSHC-ve për të rritur qendrueshmërinë e tyre mbetet një faktor kyç.

Referenca

- Bandy, J. &. (2005). *Coalitions across borders*.
- Diani & McAdam. (2003). *Social movements and networks: Relational approaches to collective action*. . Oxford: Oxford University.
- Downs, W. (2008). *Coalition*. In W. Darity (Ed.), *International encyclopedia of the social sciences*.
- EU Commission. (2019). *A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkan*. EU Commission.
- Fox. (2002). *Cross-border dialogues: US–Mexico social movement networking*. CA: University of California/San Diego, CA: Center for US-Mexican Studies.
- Fox J. (1996). *How does civil society thicken? The political construction of social capital in Rural Mexico*.
- Fox J. (2010). *Coalitions and networks: Grassroots movements, NGOs and local government*. *Alternatives*.
- Goodin, R. (2002). *Structures of Mutual Obligation*'.
- Keck, M. &. (1998). *Activists beyond borders*. Ithaca. *Cornell University Press*.
- Mona Younis. (2017). *Evaluating Coalitions and Networks*. Center for Evaluation Innovation.
- Partners Albania. (2019). *The Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development, Country Report for Albania 2018*. Tirana: PA.
- Ricardo Wilson-Grau & Martha Nuñez. (2007). *Evaluating international social-change networks: a conceptual framework for a participatory approach*.
- Sartori G. (1984). *Social science concepts*.
- Sen et al, J. A. (2004). *World social forum: Challenging empires*. New Delhi: Viveka Foundation.
- Strøm K & Nyblade B. (2007). *Coalition theory and government formation*. In C. Boix & S. Stokes (Eds.), *The Oxford handbook of comparative politics* (pp. 782–802).
- Wenger & McDermott and Snyder. (2002). *Alliance for Health Policy and Systems Research*.

Shtojcë 1: Pasaportat e Rrjeteve

Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni Shqiptar “Aftësia e kufizuar dhe Zhvillimi”			Akronimi	DDCA
Misioni	Për të nxitur gjithëpërfshirje të problematikës së aftësisë së kufizuar por edhe për të fuqizuar zërin e rritur presionin në drejtim të përmirësimeve politike e ligjore për personat me aftësi të kufizuara.				
Fusha e veprimtarisë	Të Drejtat e Njeriut dhe PAK	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2010
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Sekretariat	Znj.Blerta Cani
Anëtarë	Avokati Popullit	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	MedPAK	Qendra për Nisma Ligjore	Shoqata Ndihmoni Jetën
	GIZ	Save the Children	World Vision në Shqipëri dhe Kosovë	ANAD	Qendra Bethany
	Partnerë për Fëmijët	Shoqata e Invalideve të Punës së Shqipërisë	Qendra e Trainimit Multidisiplinor për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës	Fondacioni Shqiptar për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar	Shoqata ne Ndihme te Handikapeve Mendore, Tirana
Email	adrf@albmail.com	Telefon	+355 042 269426	Website/Facebook	N/A

Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni “Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve”			Akronimi	BKTF
Misioni	Të avokojë dhe llojojë në emër të fëmijëve për mbrojtjen e tyre, përmes krijimit të një sistemi funksional të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Të edukojë shoqërinë shqiptare të njohin dhe respektojnë të drejtat e fëmijëve. Të koordinojë dhe promovojë shkëmbimin e modeleve të praktikave më të mira në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Për të promovuar pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në çështjet që lidhen me fëmijët.				
Fusha e veprimtarisë	Të drejtat e Fëmijëve	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2003
Statusi ligjor	I pezulluar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj.Ana Majko, Z. Arjel Trajani Z. Adriatik Hasantari
Anëtarë	Terre des Hommes	Save the Children	Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara	Partnerë për Fëmijët	Fëmijët e Botës Shqipëri (FBSH)
	Ndihmë për Fëmijët(NPF)	World Vision në Shqipëri dhe Kosovë	Peace through Justice	AmaroDrom	ADRA Shqipëri
	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në	Qendra Psiko-Sociale, Vatra, Vlorë	Roma Active Albania	Shërbimi Ligjor Falas (TLAS), Tiranë	Shoqata Edukimi për Jetën (SHKEJ)

	Shqipëri- CRCA				
	Caritasi Shqiptar	Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS	SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri	Qendra Fëmijët Sot	Shërbimet Shqiptare për Refugjatë në Shqipëri
Email	ana87majko@yahoo.com arjeltrajani@gmail.com a.hasantari@gmail.com	Telefon	+355 69 52 72 948 + 355 67 21 66 873 +355 69 20 58 782	Website/ Facebook	bktfcoalition.org

Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni Drejtësi për të Gjithë			Akronimi	N/A
Misioni	Koalicioni kontribuon në një sistem të drejtësisë transparent, të pavarur dhe të përgjegjshëm, profesional dhe të besueshëm, duke u shërbyer qytetarëve dhe veçanërisht grupeve të pafavorizuara, përmes monitorimit të institucioneve të drejtësisë, avokimit dhe arsimit publik.				
Fusha e veprimtarisë	Qeverisja e mirë	Shtirirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2016
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Iris Shima
Anëtarë	Qendra Psiko-Sociale, Vatra, Vlorë	Fondacioni Shqiptar për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar	Rrjeti i Grave për Demokraci (WDN)	Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara	Shërbimi Ligjor Falas (TLAS), Tiranë
	Organizata Të Ndryshëm dhe Të Barabartë	Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale – ALTRI	Instituti i Evropës Juglindore për Kontratën Shoqërore – SSCI	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA	Shoqata për Kulturë Demokratike – SHKD
	Instituti për promovimin e zhvillimit social dhe ekonomik-IPSED	The Institute for Sustainable Policies (ISP)	Shoqata Gazetarë Profesionistë Rajonalë	Organizata Together for Life	Shoqata Antigonea
	Fondacioni Shqiptar Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi Mosmarrëveshjeve	YMCA Tirana	Qendra Kombëtare Për Shërbime Komunitare	Open Horizon	Organizata People in Focus
	Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare	Qendra Evropiane			
Email	drejtisipertegjithe@gmail.com	Telefon	+355694 805 095	Website/ Facebook	Koalicioni "Drejtësi për të gjithë"

Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni “Gratë, Paqe e Siguri”			Akronimi	N/A
Misioni	Rrjeti punon për zbatim e Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 dhe Planit Kombëtar të Veprimit të Qeverisë Shqiptare përmes monitorimit, advokimit dhe lobimit për zbatimin e tyre, si dhe ndërgjegjësimin e publikut për çështjet e sigurisë dhe paqen e grave.				
Fusha e veprimtarisë	Të drejtat e Grave dhe çështjet gjinore	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	N/A
Statusi ligjor	I Peregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Bajana Cevoli
Anëtarë	Shoqata “Gratë, Paqe e Siguri”, Durrës	Qendra Psiko-Sociale "Vatra", Vlorë	Agrita Vizion, Dibër	Shoqata Jona, Sarandë	Unë Gruaja, Pogradec
	Gruaja tek Gruaja, Shkodër	Klubi Social, Korçë	Forumi i Gruas Elbasan	Qendra "Fëmijët Sot"	AWEN
	SH.P.G.F	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Gruaja në Fokus, Durrës	Shoqata Për Zhvillim Psiko-Social-Kulturor të Fëmijëve dhe të Rinjve, Elbasan	Të ndryshëm dhe të Barabartë
	Kongresi Rinor Kombëtar	Mary Word Laureto, Shqipëri	Komiteti Rinor, Lezhë	Në Dobi të Femrës, Komuniteteve, Shtresave në Nevoje dhe Personave me Aftësi të Kufizuar	Qendra Konsumatorit Shqiptar, Durrës
	Fokus - Në ndihmë të Fëmijëve, Tiranë	Atom, Peshkopi	CSDC, Shkodër	Shoqata e Gazetarve, Elbasan	Dev-Aid, Tiranë
	Për Ju nëna dhe Fëmijë, Kukës	Dora Prindërore, Korçë	E Shkuara për të Ardhmen, Korçë	Përkrahje për të Rinjtë, Korçë	Fëmijëve Jetim, Korçë
	Instituti për Promovimin e Zhvillimit Social dhe Ekonomik-IPSED	Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare, Tiranë			
Email	gendrasociale@ yahoo.co m shoqatagrave@ yahoo.co m rezoluta1325al@gmail.com		Telefon	+355 52 234 600	Website/ Facebook http://www.siguria-paqja.al/

Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik në Shqipëri			Akronimi	KKSAT
Misioni	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti-Trafikim punon për integrimin e viktimave të trafikimit.				
Fusha e veprimtarisë	Të Drejtat e Njeriut Shërbime Sociale	Shtirirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2007
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Mariana Meshi
Anëtarë	Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë	Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit	Organizata të Ndryshëm dhe Të Barabartë, Tiranë	Shoqata Tjetër Vizion, Elbasan	
Email	kksat.al@gmail.com	Telefon	+355 42 221 892	Website/Facebook	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti - trafik ne Shqiperi

*Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni Kombëtar për Integrimin e Romëve në Shqipëri			Akronimi	NACRIA
Misioni	Mbrojen e integritetit dhe nxitjen e praktikave të suksesshme për integrimin e romëve në Shqipëri, pjesëmarrjen në debatin publik mbi përfshirjen sociale dhe ndikimin në vendimmarrjen e politikave dhe proceseve buxhetore.				
Fusha e veprimtarisë	Të Drejtat e Minoriteteve	Shtirirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2016
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Z. Bledar Taho
Anëtarë	Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri	Voice of Roma	Organizata USHTEN	Roma Active Albania	
Email	institute.irca@gmail.com	Telefon	+355 42 425 717	Website/Facebook	www.irca.al

Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri			Akronimi	ACE
Misioni	Avokimi për të drejtën universale të fëmijëve për arsimim.				
Fusha e veprimtarisë	Edukimi	Shtirirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2004
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Linda Pino

Anëtarë	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA)	Linja Kombëtare Këshillimit për Fëmijë-ALO 116	Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve	Fondacioni Shqiptarë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara	Ambasada Pink / LGBT PRO Shqipëri
	Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën Federata e Arsimit dhe Shkencës	La Casa nel Cuore Qendra Fëmijët Sot	Medpak Partnerë për Fëmijët	ADRA-Albania	Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar
Email	acce@acce.al	Telefon	+35542 242 264	Website/ Facebook	www.acce.crca.al

Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme dhe Demokraci të Qëndrueshme			Akronimi	KZLN
Misioni	Një koalicion i pavarur dhe jo-partiak me qëllimin për të kontribuar në organizimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, transparente dhe demokratike në Shqipëri nëpërmjet vëzhgimit të ushtrimit nga qytetarët të të drejtës së votës dhe të cilësisë së barazisë, bazuar në standartet ndërkombëtare të zgjedhjeve.				
Fusha e veprimtarisë	Qeverisja e mirë	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2014
Statusi ligjor	I Regjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Esmeralda Hoxha Znj. Megi Zylali
Anëtarë	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë	Organizata Dimension Human	Balkan Youth Link-Albania	Agro Puka	Roma Active Albania
	Aleanca kundër Diskriminimit LGBT	“Agritra Vision”, Peshkopi	ARSIS	Rrjeti për Fuqizimin e Grave në Shqipëri (AWEN)	Shoqata për Integrimin e Zonave Informale
	Nëna, fëmijet e ardhmja	Linja e Këshillimit për Gra e Vajza	Edukimi Social dhe Mbrojtja e Mjedisit (SEEP)	Organizata Gruaja Intelektuale Shkodrane	Fondacioni Spitalor për Nënës dhe Fëmijës
	European Movement Albania (EMA)	Qendra Zhvillimit të Shoqërisë Civile	Shoqata Në Mbrojtje të Drejtave dhe Kulturë për Fëmijë (MDKF)	Shoqata Gratë ne Fokusin e Zhvillimit Kuçovë (GNFZH)	Qendra për fëmijëri të shëndetshme, organizatë mjekësh dhe infermieresh
	Shoqata e Pavarur e Mediave Locale	Qendra e Shërbimeve Sociale	Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"	Organizata MedPAK	Shoqata”Jona”, Sarandë
	Shoqata Kombëtare për Integrim,	Shoqata Kristiane e	Shoqata "Miqësi dhe		

	Zhvillim dhe Ndihmë për Shtresat në Nevojë	Grave Shqiptare	Bashkëpunim me Europën		
Email	kzln@kzln.org.al	Telefon	+355 42 255 514	Website/ Facebook	www.kzln.org.al

Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni i Shëndetit Riprodhues në Shqipëri			Akronimi	N/A
Misioni	Misioni i rrjetit është të përmirësojë situatën e shëndetit seksual riprodhues në vend, përfshirë edukimin seksual, qasjen në kujdesin shëndetësor seksual dhe riprodhues, veçanërisht për grupin e marginalizuar.				
Fusha e veprimtarisë	Shëndeti dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese Barazia gjinore	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2012
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Brunilda Hylviu
Anëtarë	Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin	Shoqata Shqiptare e Personave që Jetojnë me HIV/AIDS	Aksion Plus	Albania Community Assist	Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare
	Qendra Psiko-Sociale, Vatra, Vlorë	STOP AIDS	Rromano Kham		
Email	info@acpd.org.al	Telefon	+355 4 2251 475	Website/ Facebook	http://acpd.org.al/

*Emri i rrjetit/koalicionit	Koalicioni Vëzhguesve Vendorë			Akronimi	N/A
Misioni	Synon zhvillimin e demokracisë në Shqipëri dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht monitorimin e proceseve zgjedhore.				
Fusha e veprimtarisë	Qeverisja e mirë	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	N/A
Statusi ligjor	N/A	Statusi aktivitetit	N/A	Drejtues/koordinator	N/A
Anëtarë	Shoqata për Kulturë Demokratike	KRIIK Albania	Women and Children Centre	Center for Human Rights in Democracy	Vlora Youth Centre
	Civil Society Development	Antigonea	Epoka e Re Youth Centre	Trokitje Youth Centre	Association for Democratic Culture

Centre					
	Shoqata në Dobi të Gruas	Saranda Youth Council	Me, The Woman	Youth in Free Enterprise	Protection of Rural and Urban Women's Rights
	Albanian Women Democratic Network				
Email	N/A	Telefon	N/A	Website/ Facebook	N/A

Emri i rrjetit/koalicionit	Kongresi Rinor Kombëtar			Akronimi	KRK
Misioni	Të mobilizojë organizatat rinore dhe të forcojë rolin e rinisë në shoqëri. Të rinjtë në të gjithë Shqipërinë do të kenë një zë të përbashkët për të avokuar dhe lobuar mbi çështje që prekin ato.				
Fusha e veprimtarisë	Të drejtat e të Rinjve	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2013
Statusi ligjor	I Regjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Dafina Peci
Anëtarë	Shoqata "Njerëzit të Parët"	Organizata Act for Society	Qëndresa Qytetare	Klubi Social, Korçë	Neë Age-Qendra Rinore Kuçovë
	AMEDA, Vlorë	Fondacioni "E Shkuara për të Ardhmen", Korçë	Fondacioni Arsimor Shqiptar	Bashkimi Rinor për Zhvillim	Grupi "ATA"
	Keshilli Rinor Belsh	Këshilli Rajonal Rinor Kukës	Shoqata Dora Prindërore, Korçë	Shoqata Përkrahje për të Rinjtë	Shoqata MAYA, Tiranë
	Fondacioni Joscelyn, Elbasan	Shoqata e Ardhmja Jonë, Tiranë	Shoqata Changing the Future, Dibër	Voice of Roma in Albania	Organizata Rinore Liria dhe Demokracia, Durrës
	Lëvizja Rinore per Demokraci, Pukë	Shoqata Maqedonase "Ilinden" - Tiranë	Shoqata Gruaja Vizion i Ndryshimit, Lezhë	Rrjeti i Organizatave "Zëri i të Rinjve"	Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin
	Youth in Charge	Organizata DoART	Organizata Vjosa Explorer	VETAR	Platforma Rinore Vorë
	Organizata Udhëtim i Lirë	Brave New Generation	Shoqata Ambasadorwt e Paqes Lezhë	Grupimi 5 Plus, Cwrrik	"YMCA Tirana"
	Përtej Barrierave	Shoqata "Vllazëria Egjiptiane"	Leadership Development Association Albania & Kosovo	Shoqata Ekspertet e Rinj Mjedisor (SHERM)	Albanian Young Leaders Forum
	Food Bank	Qendra Rinore	Fondacioni "Së	Këshilli Rinor i	Qendra Ura të

	Albania	"Perspektiva"	bashku"	Mirditës	Reja, Berat
	Nisma e të Rinjve Librazhd Mbro Lumin Shkumbin nga Ndotjet United Nations Association Albania	Kisha "Drita e Jetës Përmet"	Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive, Elbasan	Kuvendi i të Rinjve të Lezhës	Grupimi Zëri 16+
	Youth Activities Center, Durrës	Cesvi Albania Center of Development Gramsh	Organizata Liburnetik	Grupimi "The Messengers"	Rrjeti i Pedagogjisë Speciale Sociale
			Balkan Youth Activism	Qendra "Konsumatori shqiptar"	
Email	dafinapeci@krk.al info@krk.al	Telefon	+355 42 203 054	Website/ Facebook	https://krk.al/ Kongresi Rinor Kombëtar

Emri i rrjetit/koalicionit	Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Shqipëri			Akronimi	PQH
Misioni	PQH një partneritet OSHC-shtet i cili synon rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe masave antikorrupsion.				
Fusha e veprimtarisë	Qeverisja e mirë	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2014
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Pasiv	Drejtues/koordinator	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
Anëtarë	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim	Lëvizja MJAF!	Open Data Albania	Instituti për Studime Politike dhe Ligjore	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
	AULEDA	Qendra e Gruas Hapat të Lehtë	Instituti për Studime Parlamentare		
Email	info@idmalbania.org	Telefon	+355 4 240 0241	Website/ Facebook	www.idmalbania.org/open-

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti i Ekosistemit të Komunikimit Informimit Mjedisor			Akronimi	ECIM
Misioni	Misioni i rrjetit është të bashkojë dhe forcojë zërin e shoqërisë civile në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të bëhet një faktor në proceset e vendimmarrjes, duke forcuar integritetin e rrjetit të shoqatave mjedisore, rritjen e cilësisë së veprimtarive, zgjerimin e pjesëmarrjes, informimi dhe ngritja e vetëdijes publike.				
Fusha e veprimtarisë	Mbrojtja e Mjedisit	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2006
Statusi ligjor	I Regjistruar	Statusi aktivitetit	Pasiv	Drejtues/koordinator	Z. Xhemal Mato

Anëtarë	Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit (AJMMI) Shoqata Together for Life	Shoqata Egnatia	Eco- Mjedisit, Durrës	Forumi i Mendimit të Lirë	Milieukontakt Shqipëri
		Edukimi Social dhe Mbrojtja e Mjedisit (SEEP)			
Email	ekolevizja@yahoo.com	Telefon	N/A	Website/ Facebook	www.ecimalbania.wordpress.com

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri			Akronimi	AWEN
Misioni	Të punojmë së bashku për të fuqizuar vajzat dhe gratë shoqërore, ekonomike dhe politike për të marrë pjesë dhe realizuar të drejtat e tyre në të gjithë Shqipërinë, pavarësisht nga orientimi i tyre politik, feja, niveli arsimor, mosha, orientimi seksual, paaftësia, identiteti gjinor, apo faktorë të tjerë.				
Fusha e veprimtarisë	Të Drejtat e Grave dhe Çështjet Gjinore	Shtrirja gjeografike	Kombëtar/Rajonal	Viti i themelimit	2009
Statusi ligjor	I Regjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtuese	Znj. Ines Leskaj
Anëtarë	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë	Gruaja tek Gruaja”, Shkodër	Unë, Gruaja”, Pogradec	“Agritra Vision”, Peshkopi	Forumi i Gruas”, Elbasan
	Shoqata”Jona”, Sarandë	Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë	Shoqata për Gratë dhe Vajzat me Probleme Sociale, Durrës	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza – Tiranë.
Email	info@awenetwork.org ; ines.leskaj@awenetwork.org	Telefon	+355 692052 450	Website/ Facebook	www.awenetwork.org AWEN - Albanian Women Empowerment

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore			Akronimi	N/A
Misioni	Rrjeti synon monitorimin e standardeve ndërkombëtare, synon të nxisë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit CEDAW, GREVIO-s dhe UPR-s dhe të kontribuojë në adresimin e mangësive / problemeve gjatë dhe pas procesit të monitorimit dhe raportimit.				
Fusha e veprimtarisë	Të Drejtat e Grave dhe Çështjet Gjinore	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2017

Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/ koordinator	Znj. Aurela Bozo
Anëtarë	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)	Shoqata “Në Dobi të Gruas Shqiptare”	Zyra për Djem dhe Burra/ ZDB, Shkodër	Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” (QDNJD)	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
	Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”	Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare	IPSED – Instituti për Promovimin e Zhvillimit Social Ekonomik	Instituti Shqiptar për Çështjet Publike	Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)
	Fondacioni Mary Ward Loreto	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Qendra “Fëmijët Sot”	Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut	Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare
	Organizata “Gruaja drejt Integritetit”	Qendra Për të Drejtat e Gruas Rome	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPA)	Shoqata e Grave Profesioniste dhe Afariste	Qendra “Në Familje për Familjen”
	Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë	Shoqata e Personave që Jetojnë me HIV/AIDS	Shoqata Kombëtare “STOP – AIDS”	Shoqata “Refleksione”	Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI)
	Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem (CLMB)	Shërbim Ligjor Falas Tiranë	Shoqata “Zëri i fëmijëve na thërret”	Ad Litem	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)
	ALO 116	Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve	Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara
	Rrjeti për Demokraci i Gruas Shqipëri	Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes	Qendra “Gratë në Shërbim Publik”	Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale (CDRW);	
Email	avokatore2@yahoo.com	Telefon	+355 4 240 933	Website/ Facebook	www.rrjetikunderdhunesgjimore-monitorime.al Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjimore

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti i Organizatave "Zëri i të Rinjve"			Akronimi	N/A
Misioni	Të mobilizojë, integrojë dhe forcojë potencialin e të rinjve përmes ndërgjegjësimit, informacionit, avokimit dhe shërbimeve lobuese në fushat e arsimit, kujdesit, shëndetit dhe punësimit.				
Fusha e veprimtarisë	Të drejtat e të Rinjve	Shtirirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2014
Statusi ligjor	I Regjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Z. Andi Rabiaj
Anëtarë	Albania Community Assist	Aiesec Albania	Aksion Plus	Qendra Act For Society	Qendra Rinore "Epoka E Re", Fier
	Fondacioni Arsimor Shqiptar	Albanian Human Rights Group	Organizata Infinit Plus	Lëvizja Rinore Shqiptare Kundër Apatisë Shoqërore (H.A.N.A) Lezhë	Grupimi "5 Plus", Cërrik
	Organizata Roma Active Albania	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve	Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore	Qendra Trajnim, Edukim dhe Demokraci (TED)	Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare
	Shoqata Kristiane e Burrave Shqiptarë	Y-Peer Albania	Klubi Rinor "Petro Nini Luarasi"	Shoqata "Together for Life"	SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri
	Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin		European Movement In Albania		
Email	e.kica@observator.org.al arabiaj@acpd.org.al	Telefon	N/A	Website/Facebook	www.jotabu.al Youth Voice Albania

*Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti i Studentëve Shqiptare në Botë			Akronimi	ASAN
Misioni	ASAN është një rrjet gjithëpërfshirës për studentët shqiptarë që aktualisht studiojnë jashtë vendit në të gjithë botën. ASAN krijon hapësirat dhe infrastrukturën e nevojshme për bashkëpunim efektiv të studentëve shqiptarë jashtë vendit.				
Fusha e veprimtarisë	Të drejtat e të Rinjve	Shtirirja gjeografike	Ndërkombëtar	Viti i themelimit	N/A
Statusi ligjor	N/A	Statusi aktivitetit	N/A	Drejtues/koordinator	N/A
Anëtarë	Studentët shqiptarë që studiojnë jashtë vendit.				
Email	N/A	Telefon	N/A	Website/Facebook	Rrjeti Asan

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti Kombëtar i Organizatave Rome dhe Egjiptiane			Akronimi	N/A
Misioni	Qëllimi i rrjetit është të forcojë zërin Rome / Egjiptian në nivelin kombëtar duke lobuar, mbrojtur, shkëmbyer përvoja dhe praktika të mira për çështjen Rome / Egjiptian.				
Fusha e veprimtarisë	Të Drejtat e Minoriteteve	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2014
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Ilda Zajmi
Anëtarë	Organizata Romano Kham	Porta Rome për Integrim	Gruaja Rome e së Nesërme	Organizata USHTEN	A Place for All
	Roma Versitas Albania	Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)	Roma for Integration	Romano Sezi	For a better Future
	TREJA	Qendra Për të Drejtat e Gruas Rome (RWRC)	Organizata Disutni Albania	Organizata Voice of Roma	Shoqata CERA
Email	amarodrom@abissnet.al rrjeti.organizatave@gmail.com		Telefon	+355 4 223 13 91 +355 4 224 89 25	Website/Facebook Amaro-Drom

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve			Akronimi	ACRN
Misioni	Një rrjet kombëtar, i organizatave kryesore të të drejtave të fëmijëve dhe shoqërisë civile në Shqipëri, për të ndërmarrë veprime dhe nisma të përbashkëta për respektimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna, diskriminimi, abuzimi, shfrytëzimi, në jetën e përditshme apo atë virtuale.				
Fusha e veprimtarisë	Të drejtat e Fëmijëve	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	1999
Statusi ligjor	N/A	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Z. Altin Hazizaj
Anëtarë	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve	Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë ALO 116	Rrjeti Kombëtar Për të Rinjtë në Shqipëri	Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri	ECPAT Albania
	Qendra Fëmijët Sot				
Email	info@crca.al		Telefon	+355 042 242 264 +355 422 265 741	Website/Facebook www.crca.al

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri			Akronimi	ANYN
Misioni	Promovimi i të drejtave të të rinjve dhe çështjeve rinore, në nivel lokal dhe kombëtar pavarësisht bindjeve politike, statusit ekonomik, social, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësive apo grupimeve, në të cilat ata bëjnë pjesë; rritjen e angazhimit/ përfaqësimit të të rinjve në të gjitha fazat e vendimmarrjes e hartimit të politikave për të rinjtë, si dhe nxitjen e krijimit të politikave, ligjeve dhe programeve për mbështetjen e të rinjve në Shqipëri.				
Fusha e veprimtarisë	Të drejtat e të Rinjve	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2015
Statusi ligjor	I Regjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Z. Klaudio Pulaha
Anëtarë	Organizata e Personave me Aftësi të Kufizuar në Shqipëri	Ambasada Pink / LGBT PRO Shqipëri	Shoqata Europiane e Studentëve të Inxhinierisë Elektrike - EESTEC	Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë	La Casa nel Cuore
	Komiteti Rinor Lezhë	Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri	Koalicioni për Nxitjen e Grave dhe të Rinjve në Politikë	ALO 116: Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijët	Qendra Rinore, Pukë
	New Vision	Open Mind Spectrum Albania	Organizata Rinia Studentore	Qendra Rinore PO , Tiranë	Organizata USHTEN
	The International Association for the Exchange of Students for Technical Experience	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri - CRCA	Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri	Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës - CSDC	Shpresë për të Ardhmen, Shkodër
	TAMAM Albania	Zëri i Romëve në Shqipëri	Youth Action (Të Rinjtë në Veprim) Korçë	Forumi Rinor i Aleancës Kuq e Zi	Forumi Rinor i Partisë së Bashkimit për të Drejtat e Njeriut
	Forumi Rinor i Partisë së Frymës së Re Demokratike	Klubi i Patriotëve të Rinj	Lëvizja Rinore për Integrim	Qendra Rinore Aulona, Vlorë	
Email	info@crca.al klaudio.pulaha@crca.al		Telefon	+355 42 265 741	Website/ Facebook www.crca.al

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti Kundër Varfërisë	Akronimi	N/A
Misioni	Qëllimi i rrjetit është të organizojë dhe koordinojë përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimin social brenda vendit; angazhojë individë, grupe dhe organizata të synuara në veprim, dhe promovojë dhe përfaqësojë rrjetin në organizata dhe institucione të tjera ndërkombëtare.		

Fusha e veprimtarisë	Varfëria dhe përfshirja sociale	Shtirirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2012
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Garentina Gramo (Perdhiku)
Anëtarë	Diakoni Agapes, Tiranë	Organizata Dorcas Aid International, Korçë	Fondacioni “Emanuel Mission”, Korçë	For Gender Integration, Tiranë	Qendra Blegtoria dhe Zhvillimi Rural, Tiranë
	Qendra Kombëtare Për Shërbime Komunitare, Tiranë	Shoqata Integrimi, Tropojë	Shoqata Për Gratë dhe Fëmijët, Tiranë	World Vision në Shqipëri dhe Kosovë	ANTTARC
Email	daoffice@diakoniaga.pes.org	Telefon	355 4 2266 452 355 4 2266 378	Website/Facebook	N/A

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti “Një sy për mjedisin!”			Akronimi	N/A
Misioni	Mbrotjtja e mjedisit duke promovuar zbatimin e ligjit dhe aktivizmin qytetar.				
Fusha e veprimtarisë	Mbrotjtja Mjedisit Roli mbikqyrës (watchdog)	Shtirirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2013
Statusi ligjor	I Paregjistruar (rrjet tematik)	Statusi aktivitetit	Aktiv	Partneri Drejtues/Person kontakti	Qendra EDEN Znj. Lira Hakani
Anëtarë	Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN), Tiranë	Klubi Ekologjik, Elbasan	Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore (FSEW), Berat	Qendra e Informacionit Aarhus (AIC), Shkodër	Qendra për Kërkim, Bashkëpunim dhe Zhvillim (CRCD), Vlorë
	Qendra për Mbrotjtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)	Shoqata në Mbrotjtje të Jetës dhe Ekosistemit përreth fabrikës Titan – Burizanë			
Email	vigjilenca@eden-al.org eden@eden-al.org lira.hakani@eden-al.org	Telefon	+355 42 227 615	Website/Facebook	www.eden-al.org Nje sy per mjedisin

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti “Për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri”			Akronimi	N/A
Misioni	Rrjeti synon të mbrojë dhe promovojë natyrën në vend, kryesisht ato të zonave të mbrojtura dhe burimeve natyrore.				
Fusha e veprimtarisë	Mbrojtja e Mjedisit	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2013
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Nihat Dragoti
Anëtarë	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, Tiranë.	Green and Clean, Korçë	Forumi Ndërkufitar i Liqenit të Shkodrës	Mbrojtja e Natyrës dhe Administrimi i Mjedisit-Adriatik, Vlorë	Shoqata “Miqësia”, Ulëz
	Shoqata Mjedisore Çajupi, Gjirokastrë	Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit, Kukës	Mbrojtja dhe Zhvillimi Social-Iliria, Tiranë		
Email	info@inca-al.org	Telefon	+355 42 231 437	Website/Facebook	www.inca-al.org

Emri i rrjetit/koalicionit	Rrjeti Qendrave Komunitare “Sot për të Ardhmen”			Akronimi	CDC-TFF
Misioni	Rrjeti synon arritjen e kohezionin shoqëror, ekonomik, politik dhe kulturor të shoqërisë duke priorizuar barazinë gjinore, nëpërmjet aplikimit të qëndrimeve dhe sjelljeve të reja liberale dhe demokratike; ndërmjetësimin që promovon bashkëjetesën dhe bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme gjinore, moshore, etnike, kulturore, fetare, dhe forcimin në këto komunitete të vlerave të diversitetit, tolerancës, demokracisë dhe bashkëjetesës, unitetit social e barazisë gjinore, duke punuar për zbatimin e këtyre principeve nëpërmjet lobimit, advokacisë, e dhënies së praktikave më të mira të shërbimeve për komunitetet <u>multi-etnike multikulturore, gratë, të rinjtë, fëmijët dhe moshën e tretë në nevojë.</u>				
Fusha e veprimtarisë	Të drejtat e Njeriut Shërbimet Sociale Punësimi, Edukimi Kultura, arti, promovimi i vendit; Mbrojtja Mjedisit Qeverisja e Mirë	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2013
Statusi ligjor	I Regjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Znj. Fabiola Egro
Anëtarë	Qendra Sot për të Ardhmen në Durrës	Qendra Sot për të Ardhmen në Tiranë	Qendra Sot për të Ardhmen në Shkodër	Qendra Sot për të Ardhmen në Korçë	Qendra Sot për të Ardhmen në Pukë

Email	info@cdc-tff.org	Telefon	+355 42 247502 + 355 42 302 410	Website/ Facebook	www.cdc-tff.org
--------------	--	----------------	------------------------------------	------------------------------	--

Emri i rrjetit/ koalicionit	Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural			Akronimi	ANRD
Misioni	Promovimi dhe jetësimi i zhvillimit rural të udhëhequr nga komuniteti nëpërmjet advokacisë dhe nismave në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm rural me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës të komuniteteve rurale në Shqipëri.				
Fusha e veprimtarisë	Zhvillimi Rural	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2015
Statusi ligjor	I Regjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/ koordinator	Znj. Evelina Azizaj
Anëtarë	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim	Agritra Vision	Agro Puka	Fondacioni CESVI Onlus	Gratë në Bujqësinë e Qëndrueshme
	Shoqata e Zhvillimit të Bujqësisë së Rretheve Malore (ADAD Malore)	Reggio Terzo Mondo	Foundacioni Dorcas Aid Albania	Instituti i Bujqësisë Biologjike	Instituti për Paqe, Zhvillim dhe Inovacion Acli
	Agjencia për Zhvillimin e Zonave Malore (MADA)	Programi për Mbështetjen e Shoqatave Rurale	Fondacioni për Zhvillimin e Mirditës (pezulluar)	Qendra për Zhvillim dhe Integrim	COSPE – Bashkëpunimi për Zhvillimin e Vendeve në Emergjencë
	VIS Albania	Vizion i Gjellbër	World Vision në Shqipëri dhe Kosovë	Aleanca e Alpeve Shqiptare	Shoqata Integrimi
	Shoqata Pro Përmet	AgriNET			
Email	info@anrd.al eazizaj@idmalbania.org	Telefon	+355 (04) 2400 241	Website/ Facebook	www.anrd.al

Emri i rrjetit/ koalicionit	Rrjeti Skena e Pavarur Kulturore në Shqipëri			Akronimi	SPK
Misioni	Qëllimi kryesor i rrjetit është të sigurojë kushte të barabarta veprimtarie të krahasuara me ato të institucioneve publike, dhe të përmirësojë pozicionin e njerëzve të kulturës dhe artit në shoqëri.				
Fusha e veprimtarisë	Arti dhe Kultura	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2013
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/ koordinator	Z. Andi Tepelena
Anëtarë	Art Kontakt	Albania Dance	Albania Art	Argjiro	Fondacioni EDS

		Company	Institute		
	Fondacioni Gjirokastra	Fondacioni H2H	Shoqata Cesvi	Open Doors	Tirana Art Lab
	Shoqata DoArt	Revista Aleph	Zenit: The Promenade Gallery		
Email	info@spk.al	Telefon	+355 42 275 658	Website/ Facebook	www.spk.al

Emri i rrjetit/koalicionit	Përgjigje e Bashkuar Kundër Trafikut			Akronimi	URAT
Misioni	URAT punon për të koordinuar përpjekjet kundër trafikimit midis agjencive, organizatave dhe individëve dhe përpiqet të promovojë dinjitetin njerëzor dhe të krijojë një rrjet të fortë burimesh për ata që janë të përfshirë në përpjekjet kundër trafikimit dhe viktimat e trafikimit.				
Fusha e veprimtarisë	Të drejtat e Njeriut Shërbimet sociale	Shtrirja gjeografike	Kombëtar	Viti i themelimit	2010
Statusi ligjor	I Paregjistruar	Statusi aktivitetit	Aktiv	Drejtues/koordinator	Z. Erion Prendi
Anëtarë	Shoqata Kombëtare Edukim për Fëmijët	Qendra Psiko-Sociale "Vatra"	Terre des Hommes Shqipëri	Mary Award Loreto, Shqipëri	Peace Corps
	Organizata Të ndryshëm të barabartë	Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS	Tjetër Vizion		
Email	erioprendi@gmail.com	Telefon	N/A	Website/ Facebook	N/A